Kemi të bëjmë me një bazilikë me transpet mjaft të ngjashme me bazilikën e Butrintit[47]. Gjatësia e kishës përfshirë dhe absida me diametër 5,20 m ishte 26,30m, gjërësia e nefit qëndror 6.40m., gjërësia e transeptit 3.30 m ndërsa gjatësia e njërit krah në to 4.30 m. Nga nefi qëndror i kishës ruheshin dy muret anësorë 0.75 m të gjërë të cilët në një lartësi prej 0.40 m përfundonin me pllaka të mëdha e të rregullta gëlqeror. Mendojmë se këto përbëjnë bazamente mbi të cilin ngriheshin (mbi pilastra apo kolona) harkadat ndarëse të dy nefeve[48]. Nga të dy këto mure, bazamente për harkadat, ruheshin më mirë ai nga veriu. Në këtë mënyrë kisha e Finiqit paraqiste një bazilikë paelokristiane të mezit të shek. VI[49], në të cilin pas shkatërrimit rindërtohet një kapele e vogël, me një narteks të vonë e pas tij, në anën jugore një hajat. Ashtu siç rezultoi mjaft i dëmtuar bazamenti i harkadës jugore; edhe muri jugor mund të ketë qenë prishur për të ripërdorur materialet e tij (në qoftë se kjo pjesë u gërmua nga Ugolini) dhe kështu nuk u gjet asnjë gjurmë e murit mbi sipërfaqe të tokës.

Gjatë gërmimit janë gjetur kapitele dritaresh, kapitele të tjerë dhe pllaka të ikonostasit fundit mund ti takojnë edhe kishës mesje aq sa mund të gjykohet nga fotot e Ugolinit

Baptisteri[50] është ndërtuar pranë baz rrënojat e thesaurosit antik të Finiqit, në br të cilit pas gërmimit u gjet vaska e ruajtur mirë. Vaska ishte me diametër 0.90 m dhe thellë. Muret anësore të saj janë të ndër mënyrë të çrregullt me gurë e tulla të ripër të lidhura me llaç gëlqereje. Në brendësi va dy herë e suvatuar dhe ka pjerrësi fundore Në plan vaska paraqet një kryq, me brinj 0,65-0,75m të gjëra dhe 0,75 m të larta. N nga krahët e kryqit kishte një të futur në fo për arsye funksionale. Gjatë gërmimit u gj fragmente mermeri dhe murature që flisnin baldakim mbështetur mbi katër kolona që dhe mbulonte vaskën. Dyshemeja e baptis te e rindërtuar me tulla e gurë 15 cm në e dikurshëm (të thesaurotit). Gjatë gërmim tën gjurmë djegjeje që flasin për një shka godinës[51]. Nga një mbishkrim i gjetur në n e vaskës, mendohet që ndërtimi i baptister jo më i hershëm se shek. VI, madje Ugolin het dhe për më vonë. Ne mendojmë se duhet të jetë i njëkohëshëm me kishën dhe sion të saj, i mezit të shek. VI.

Bazilika e Mesaplikut Vlorë, ka dalë nga gërmimi arkeologjik në vitin 1979 në quajtur «Bregu i Kishës» rrëzë kodrës së nës[52]. Paraqet një bazilikë trenefshe, pa nc përmasa 13,80 x 11,0 m, (Tab. II). Nefi qënd 4,50 m i gjërë, anësoret 2,50 m. Është për tu që dyshemeja e nefit jugor është 0,25 m m se ajo e pjesës tjetër të kishës. Në anër është absida trefaqëshe. Muret e bazilikës

---

46) L.M. Ugolini, **Albania Antica, L'Acropoli di Fenice II,** Roma-Milano, 1932, 123-133, fig. 63-68.100,107. (A, b) Sipas tij, që me përfundimin e gërmimit monumenti është dëmtuar, po kështu kanë humbur apo prishur fragmentet arkitektonike. Në këto rrethana është vështirë të gjykohet për kronologjinë e rindërtimeve që janë bërë mbi rrënojat e kishës.

47) D. Pallas, **R.b.k,** II, 1971, ka korigjuar planin e dhënë nga Ugolini, në të cilin mungon nefi jugor.

48) L.M. Ugolini, **Vep. cit,** 130 – 131. fig. 16. mendon se nefi anësor është një ambient ndihmës, ndërsa muri me pllakat gëlqeror, pjesa e jashtme e murit që kufizonte nga veriu naosin, dhe se ky ambient (nefi verior, sipas nesh) ishte një

DO NOT COPY

DO NOT COPY

mjaft të rrënuara dhe jo kudo të ruajtura. Muret janë të ndërtuara me gurë të çrregullt dhe të lidhura me llaç të bollshëm. Nuk ruhen as hyrjet që duhet të kenë qenë në anën perëndimore.

Dyshemeja e naosit ka qenë e shtruar me mozaik. Motivet e përdorura janë ato gjeometrike, bimore, shtazore si dhe një portret në nefin verior[53]. Në anën lindore të nefit qëndror dyshemeja ndërpritet nga muret bazamente të ikonostasit që ndante ambientin e altarit nga naosi. Dyshemeja e tij është një këmbë shkallë më lartë se naosi. Një varr u gjet në brendësi të ambientit të altarit.

Kisha ka qenë mbuluar me çati druri. Për këtë dëshmojnë gjetjet e shumta të gozhdëve nën shtresën e tjegullave, që së bashku me gjurmët e djegjes flasin për një rrënim të dhunshëm të ndërtesës. Bazilika është datur në gjysmën e parë të shek. VI.[54]

Bazilikat e Bylisit. Në këto vitet e fundit në qytetin antik të Bylisit, qendër peshkopale, po dalin në dritë nga punimet arkeologjike dy bazilika të mëdha paleokristiane të emërtuara nga zbuluesi i tyre S. Muçaj, bazilika A dhe bazilika B.[55] Një e tretë dallohet në gërmadhat e qytetit.

Bazilika A është tre nefshe me arkada mbi pilastra që ngrihen mbi një mur të ndërtuar me gurë e llaç gëlqere me transept, krahët e të cilit ndahen nga pjesa qëndrore me arkada mbi kolona duke komunikuar njëkohësisht me dyer me anën lindore. Në anën lindore del absida gjysëm rrethore në brendësi të së cilës ruhet sinthroni me tre këmbë shkallë. Në anën lindore të nefit qëndror është ambienti i altarit i ndarë me parapete. Nefi jugor është më i gjërë se sa nefi verior. Naosi paraprihet nga narteksi me të cilin lidhen me tribelion me nefin qëndror dhe me dyer anësorë. Një mjedis del në anën jugore të narteksit. Narteksi vet paraprihet nga një portik në të cilin hyhet nëpërmjet një shkallareje për shkak të vendosjes së pjesës perëndimore të bazilikës në tërësi të pjerrët. Dyshemeja e bazilikës është e shtruar me mozaik shumëngjyrësh. Bazilika mendohet se i takon mezit të shek. V.[56].

Bazilika B gjithashtu e vendosur në terren të pjerrët paraprihet nga një shkallare prej së cilës kalohet në një portik që paraprin atriumin, më tej është një ekzonarteks dhe narteksi prej të cilit hyet në naosin trenefësh me transept. Gja thëshme e kompleksit arrin në 94 m. kalohet në nefin qëndror nëpërmjet dhe po me të njëjtën mënyrë me mje sterit. Narteksi lidhej me ekzonarteks lime mbuluar me harqe. Në anën jugo dhoma ndihmëse ndërsa në anën ver llë të hip në katin e dytë, në galeri. ndimore ndodhej dhe atriumi, një po mbi kolona.

Edhe në këtë bazilikë nefi jugo gjërë se ai verior. Në këtë bazilikë a të nefeve janë mbi një murë të vazhd prej gurësh të mëdhenj të punuar ml kolonat e arkadave. Dyshemetë e bo shtruara me mozaik me motive gjeom kafshë dhe figura njerëzore. S. Muç bazilika duhet të jetë ndërtuar gja -530[57].

Rrënojat e kishës së Shën Gjer ndodhen në bregun e djathtë të Dri qen e pjerrët të terrenit ruhen gjurr mureve perëndimor dhe të absidës. (sia e përgjithshme e ndërtesës, përfs absida është rreth 19.10 m ndërsa 20.20m. Nga pjesët në dukje të mu kuptohet që ndërtesa ka qenë një ba Kështu ruhen këndi jugperëndimor i perëndimor në pjesën e nefit jugor pilastri në të, arkadës jugore të bazil veriperëndimor, muri verior ruhet n 3.30 m, po kështu ruhet i plotë dhe p e arkadës veriore. Muri perëndimor het qartë nga rrënojat. Muret janë nd mesatarë e të vegjël lidhur me llaç ndonjë vend fragmente tjegullash. M ruhet deri në 1.50 m lartësi mbi terr

Në anën lindore të ndërtesës 1.4 e naosit ruhet rreth 3.50 m nga absid ratura është me gurë dhe pjesë të n Kjo pjesë e murit ruhet në një lartësi muri perëndimor rezulton në këtë n rreth 4.50 m i lartë.

Me të dhënat që ofron monum mund të bëhet veçse në kufijt koho Në se kapiteli që ruhet në muzeun

DO NOT COPY

ketë ardhur me siguri prej kësaj ndërtese, bazilika duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. V. Kisha vazhdon të jetë në përdorim për një kohë të gjatë. Ajo përmendet në shek. e XVII si një ndër kishat e qytetit dhe në gjendje të mirë.[58]

Bazilika e Ballshit. Në qendrën e rëndësishme të antikitetit të vonë dhe mesjetë, Ballsh-Kefalini--Gllavenicë nga gërmimi arkeologjik ka dalë në dritë një bazilikë mjaftë me vlerë si në aspektin arkitektonik ashtu dhe për historinë mesjetare.[59]

Kemi të bëjmë me një kishë manastiri të cilës në kohë i janë shtuar dhe ambiente të tjera ndihmëse. Duke përbërë në këtë mënyrë një kompleks të gjërë. Në planimetri kisha paraqet një bazilikë trenefshe, me narteks dhe ekzonarteks sidhe një kapele në anën veriore. Gjatësia bashkë me narteksin është 22.50 m ndërsa gjërësia 17,20 cm.

Nga ndërtimi i vjetër ruhen si forma planimetrike fillestare e lexueshme qartë ashtu dhe muret e vjetra vende-vende të rindërtuara siç është në anën lindore ashtu dhe pjesë të murosura më vonë. Secili nga tre nefet përfundon me absidë prej të cilave ajo e qëndrës që është dhe më e madhe është trefaqëshe, ndërsa dy të tjerat janë gjysëm rrethore. Në brendësi të absidës qëndrore, ruhet në trajtë shkallareje sinthroni. Të tre nefet ndahen nëpërmjet një harkade ku alternohen pilastrat në muret fundore, dy shtylla graniti (2.40 m të larta dhe diametër 0,50) dhe një pilastër (me përmasa 1.40 x 1.00m).

Narteksi lidhej me naosin nëpërmjet dy portave njëra në qëndër e tjetra në nefin jugor. Një portë tjetër lidhte nefin verior me ambientin pranë kishës dhe kapelën pranë.

Muret e vjetra të kishës janë ndërtuar me teknikën e përzjerë me gurë të skuadruar e breza pesë rradhëshe tullash lidhur me llaç në ngjyrë të kuqërremtë në fuga të trasha. Në ndërtimin e janë përdorur në masë materiale antike të pr Bylisi aty pranë. Të tilla janë mjaftë elem skulpturës zbukuruese ashtu edhe katër r me[60].

Në bazilikë janë bërë dhe mjaft rindër ta mbajtur në përdorim mbas dëmtimeve të që ka pësuar në kohë si edhe në ndrys shumta funksionale. Rindërtimi i parë ës gurë lumi e llaç balte për lidhës.

Sipas studjuesit të saj S. Anamali, bazili ndërtuar në shek. e VI, dhe rindërtimet e sc kasin njëri shek. XI dhe tjetri pas shek. XII. rindërtim duhen futur dhe po aq rindërtime shemesë.[61]

Me vlerë të veçantë janë gjetjet e sk zbukuruese që i takojnë ndër të tjera ikono dikurshëm. Të tilla janë pilastrat e shtyllave nuara në gurë gëlqeror me motive, nga botc dhe ajo shtazore.

Bazilika e Shën Mëhillit në Arapaj të D ka dal në dritë me gërmimet e filluara siste që nga viti 1980. Ajo ndodhet në kodrën e Sl hillit pranë fshatit Arapaj, në vendin ku më 1081 u rrethua prej normanëve dhe u shp garda perandorake e Aleks I Komnenit.[63]

Kisha e Shën Mëhillit paraqet një bazi nefshe, me tre konke me narteks dhe atrium perëndimore dhe një ambient në anën ju naosit. (Tab. IV). Përmasat e naosit janë 34 duke qenë nefi qëndror dy herë më i gjërë se c Në anën lindore është absida gjysëm rrethc madhe se dy anësore (Diametri i saj 7 m nd anësorëve. Deri më sot nuk janë zbuluar t për arkadat ndarëse të bazilikës, veç mureve të vazhduara mbi të cilat ngriheshin ato

58) F. Prendi, **Vendvarrimi i Skënderbeut.** Në Konferencën e II, Studimeve Albanologjike, II, Tiranë 1969.

59) S. Anamali, **Bazilika e Ballshit,** Iliria, VII-VIII, 302-304, Tab. I-II, **Po ai, Rreth skulpturës dekorative arkitektonike të bazilikës së Ballshit,** Iliria 2/1981, 237 – 242.

60) C. Praschniker, **Zwei mittelalterliche inschriften aus Albanien,** Anzaiger der Phil-hist. kl. der. Akad. Wise, Wien 1922-3-11, C. Prachniker, **Muzakhia und Malakastra** J.O.A.I. Wien 1922, 194-195, fig. 111 veç sa më sipër shih. dhe S. Anamali. Kumtesa **Nga Ilirët tek Arbërit,** Beograd 1984.

61) **Vep. cit,** 303.

DO NOT COPY

duhet të ketë qenë i shtruar me pllaka mermeri, gjurmë të të cilave gjejmë në skajet perëndimore të naosit[64], si dhe në krahun verior të ambientit të altarit. Kisha ka qenë ndërtuar me mure guri e rrasa tullash në fuga të trasha (7 – 8 cm) të llaçit gëlqeror me murë guri e rrasa tullash në fuga të trasha (7 – 8 cm) të llaçit gëlqeror me rërë të trashë. Muret gjatësorë janë 0,80 m të trasha ndërsa ai i absidës lindore 1.50 m. Në të kemi një shkallë «sintroni» dhe gjurmë të pikturës murale. Në naos hyhet nëpërmjet hyrjeve në anën perëndimore si dhe nga dy dyer në murin jugor dhe një në atë lindor në pjesën që i takon nefit verior.

Narteksi këtu mungon sepse naosi paraprihet nga atriumi i gjërë. Pjesa e brendshme e atriumit është një portik me përmasa 11,50 x 11,50 m, me trashësi të mureve 0,65 m të ndërtuara me tulla dhe pilastra mbi një mur bazament. Mbi pilastrat kalonte një harkadë treshe për secilin krahë të atriumit. Dyshemeja e atriumit është e rregullt dhe e shtruar me tulla mbi shtresë llaçi. Në qendër të tij është një pus. Në atrium hyej nga një portë në anën jugore, nga e cila ruhet pragu. Mundet që një hyrje tjetër të ketë qenë në anën perëndimore. Dy hajate janë shtuar më vonë në anët veriore dhe jugore të atriumit.

Në jug të naosit i lidhur me të me një portë ndodhet një ambient (me përmasa 6 x 9 m) i shtruar me mozaik shumëngjyrësh me figura njerëzore, kafshë dhe dekor bimor e gjeometrik.

Monumenti është datuar në shek. VI dhe vazhdoi të përdoret deri në shek. XV. Të kësaj kohe janë gjetjet më të vona monetare[65]. Krahas mozaikut janë zbuluar dhe fragmente të shumta gjeometrike nga skulptura arkitekturore e ndërtimit fillestar si parapete, kapitele dhe shtylla. Mbas një dëmtimi të parë kisha rindërtohet duke u shtruar me tulla e më vonë pas djegjes së saj më 1081 të zvogëlohet me përmasa duke përbërë një kishë modeste në pjesën lindore të bazilikës.

Bazilika Paleokristiane në Paleokastër Gjirokastër. Në brendësi të kështjellë së Paleokastrës, ruhen rrënojat e dy kishave paleokristiane të gërmuara në vitin 1974[66]. Njëra prej tyre p zilikë trenefshe të ndërtuar pranë (Tab. V) mbi rrënojat e kapanoneve e djegur në gjysmën e dytë të shek kishë e vogël njënefshe jashtë kështj me mure.

Bazilika[67] paraqet një ndërtesë ruhet me mure pak mbi tokë çka ku që mund të nxirren nga monumenti. ndimore paraprihet nga narteksi i (me përmasa 3,05 – 3,39 x 11,43n ambient me planimetri katrore në ai re (me përmasa 4.70 x 3.75 m), në t përmbysur një pllakë me mbishkrimi e kështjellës. Naosi ka përmasa të x 13,85 m dhe ndahet në tre nefa. ndarëse ruhen vetëm themelet e va cilat ngriheshin me mjaftë gjasë pila dror është mjaft më i gjërë (5,23 m) (2.40m). Në anën nga lindja ndodhen të cilave qëndrorja më e madhe dhe shtë se nefi, ndërsa më e vogla në f gor, me gjërësi sa të nefit (Tab. V). është një këmbë shkallë më e lartë naosit. Një ambient i vogël me hyrje dhet pranë murit jugor.

Në anën lindore të nefit qëndrc i ikonostasit që duket se ndante am nga naosi. Nga ky ambient u gjetën që duket se i përkasin tryezës së al mbajtëse e saj me kapitel dhe nj tryezës.

Muret e bazilikës janë ndërtuar dhe lidhen me llaç gëlqereje të dob tyre (0,60 x 0,73 m) flet për mbulimi druri në një ose dy nivele (më lartë

Datimi i bazilikës është bërë si diçka më vonë,[68] duke u nisur ng rrënojat e kapanoneve dhe forma e ndërtimit. Mundet që për një da shtynë prania e absidës së dytë në flet për një diakonikon të zhvilluar, gjysmën e dytë të shek. VI.[69]

Bazilika prapa Pallatit të Kulturës – Sarandë[70] Kohët e fundit në pjesën lindore të kështjellës është zbuluar dhe po gërmohet një bazilikë trenefshe me arkada mbi pilastra e rrethuar nga disa mjedise ndihmëse. Nga gërmimi rezulton gjithashtu se nën dyshemenë me mozaik të bazilikës ruhet një nivel tjetër dyshemeje me mozaik. Dyshemeja e bazilikës zbukurohet me mozaik me motive gjeometrike, bimore dhe nga bota e kafshëve. Gjatë gërmimit janë zbuluar fragmente të shumta të skulpturës që i takon kryesisht pllakave ndarëse të ambientit të altarit. Teknika e ndërtimit të mureve si dhe mozaikët tregojnë për dy faza ndërtimore të kishës, njëra e shek. V dhe tjetra e mezit të shek. VI, me shumë gjasë në kohën e sundimit të Justinianit.[71]

NDËRTIMET ME PLANIMETRI QËNDRORE

Ndërtimet me planimetri qëndrore që ruhen në Shqipëri, mjaft të rëndësishme për nga vlerat janë dy: Kisha e Linit (Pogradec) dhe Baptisteri i Butrintit.

Kisha trekonkshe e Linit, Pogradec[72] përbëhet nga naosi, dy kapela me absidë në jug dhe në veri të tij, baptisteri, atriumi dhe një kapele katër konkshe në të cilën zbritet me disa këmbë shkallë në anën veriore (Tab. VI). Naosi përbëhet nga ambienti qëndror që përfundon me absidën gjysëm rrethore në anën lindore dhe dy galeri anësore, gjysëm rethore në plan, si në anën veriore ashtu dhe atë jugore, që përbëjnë dy konke më të vogla. Muret ndarëse për këto galeri anësore, janë gati rrafsh me dyshemenë, kështu që forma e tyre e parë mund të rikrijohet për analogji me ndërtime të ngjashme, si ajo tetrakonkale e Lyhnidit (Ohri i Sotëm), Stoa e Adrianit në Athinë, e Perushticës (Bullgari) dhe e Rusafës (Siri)[73]. Ndër to ngjashmëria më e madhe, më saktë lidhja e drejtë përdrejtë vërehet me atë të Ohrit, skemën planimetrike të të cilit me disa thjeshtësime e ndonjë dallim, riprodhon kisha me përmasa më të vogla e Linit. Nga krahasimet me ndërtimet e mësipërme kuptohet se galeritë anësore ndahen nga harkada mbi mure të ulët si xokol.

Naosi lidhet me narteksin nëpërmjet tr
një e madhe për ambientin qëndror dhe c
vogla për galeritë anësore. Narteksi relativis
shtë zë tërë ballin perëndimor të naosit. N
anët e ngushta të narteksit ndodhen dy kap
ra katrore dhe me absidë nga lindja, tjetr
këndëshe dhe me absidë nga jugu. Në lind
saj të fundit ndodhet salla e pagëzimit m
metri katror. Në mes të saj është vaska m
metri katërfletërshe. Përpara narteksit ndodh
mi me mure të mbyllura dhe dy kontraforte
hyrjes. Në pjesën qëndrore të atriumit ngr
pilastra harkada që formonte oborrin e rret
galeri në mes të të cilit ndodhej zakonisht
Në anën veriore të sallës nëpër derë zbritej
këmbë shkallë në një kapele të vogël me pl
katërfletërshe e shtruar si edhe shkallët me

I gjithë kompleksi i ka dyshemetë të
me mozaikë. Gjurmë të tij ka deri tek hyrja
atrium, çka flet qartë për vlerat artistike të
mentit. Mozaiku shumëngjyrësh ka dekor
bimor e gjeometrik, ku mbizotërojnë simbole
tit. Secili nga ambientet zbukurohet nga sken
çanta. Ambienti në veri të narteksit ka si mo
dror brenda një katrori një kantar me vile
zogj e në qoshet e tij skenën e eukaristisë
ka dekor gjeometrik brenda një brezi dekorati
fishtë gërshetash. Ambienti në jug të nartek
bëhet prej dy panelash, ai i absidës paraqet
stinë, i pjesës tjetër me dekor gjeometrik dh
shpendësh. Përsa i përket sallës qendrore mo
së cilës janë mjaft të dëmtuar, mbizotëron
zoomorf e bimor.

Gjatë gërmimit të kishës janë zbuluar dh
të ikonostasit të dikurshëm, kollona e pllaka
rapetit prej mermeri, në të cilat janë gdhen
qe. Ikonostasi dhe ambienti i altarit duket
pjesën e fundit të ambientit qëndror, përpa
sidës. Duke u nisur nga trashësija e vogël e
(0,70m) mendohet se kisha duhej të mbulo
çati druri.

Në aspektin tipologjik lidhjet më të mëd
hen me kishën katërkëndëshe të Ohrit[74], që

70) K. Lako, **Dinamika e zhvillimit të Onhezmit (shek. IV p.e.sonë – shek. VI e.sonë)** Kuvendi i II i Studimeve Ilire Tiranë Shtator 1985, R. Sörries, **Vep. cit,** fig. 23,.

DOKTORATURA

dhe në vendosjen e baptisterit në anën jugore. Duke patur parasysh si afërsinë planimetrike, vendndodhjen e tyre, ngjashmërinë stilistike të mozaikëve dhe të përmbajtjes së skenave të tyre, mendohet se kisha trekonkshe e Linit duhet të jetë ndërtuar në fillim të shek. VI.[75] Kisha e Linit ka ngjashmëri me monumente të tjerë të këtij rajoni, sidomos me bazilikën e Studençistës. Në dritën e këtyre afërsive mund të mendohet se ajo është ndërtuar nga të njëjtat atelje ndërtimore e të mozaikëve që vepronin në zonat e liqenit të Ohrit, rreth qytetit të rëndësishëm ilir të Lyhnidit, që bënte pjesë në provincën e Epirit të Ri. Me planimeri trekonkshe është edhe një ndërtim akoma i pa gërmuar pranë kanalit të Vivarit në Butrint.

Baptisteri i Butrintit[76] përbën një nga dëshmitë më me vlerë të arkitekturës dhe artit të shekujve V--VI në vendin tonë, rëndësia e të cilit kalon kuadrin lokal, duke qenë baptisteri më i madh me planimetri qëndrore në botën mesdhetare. Baptisteri përbëhet prej dy ambientesh, vet të sallës së pagëzimit dhe një salle tjetër në anën veriore mbi murin verior të së cilës është ngritur më vonë një kapele e datuar në shek. IX-X. Salla e pagëzimit ka planimetri rrethore me diametër rreth 13,5 m që i brendashkruhet një katrori, duke formuar në këtë mënyrë në këndet ambiente të vegjël ndihmës (Tab. VI) Brenda sallës janë dy rradhë prej tetë kolonash, të vendosura simetrikisht sipas rrethit, duke e ndarë në këtë mënyrë sallën në tre unaza bashkëqendrore në qendër të të cilave është vaska e pagëzimit. Si kolonat prej graniti ashtu edhe bazat e tyre janë të marra nga ndërtesa antike. Ai ka 24 pilastra me prerje gjysëm rrethore. Në sallë hyhet nga një portë në anën perëndimore dhe një tjetër që e lidh me dhomën në veri. Në anën lindore ka tre dritare në nivele të ndryshme dhe një nike me një rezervuar të vogël uji nën dritaren e mezit.

Muri i jashtëm sipas katrorit dhe ai rrethor janë ndërtuar në të njëjtën kohë dhe kanë të përbashkëta pjesët e kontaktit duke shfrytëzuar dhe pjesë muresh të vjetra siç vrojtohet në anën veriore dhe atë jugore. Me kohë ndërtesës i janë shtuar ambiente të tjerë.

Për ndërtimin e brendshëm ka
Gjatë gërmimit dimë se në pjesën që
janë gjetur pjesë qemeresh me mura
të suvatuara me llaç gëlqereje e të
blu e të kuqe të errët. Krahas tyre j
arkitrarë prej graniti me anën e bre
kuar e të jashtmen të drejtë gjitha
suvaje të ngjyrosur. Ata duhej të isl
duke patur nga një kryq të gdhendur
shtme. Kjo tregon se mbi këtë unazë
sur një tambur rrethor mbuluar me
një kësulë sferike, ndërsa mendojmë
e sallës mbulohej me qemere të k
unaza, në të kundërt nuk kishte pse
dy rradhë kolonash. Një zgjidhje e til
tetike justifikon qënien e murit të jas
qenë edhe më i ulët në qoshet do t
pjesën rrethore.

Dyshemeja me mozaik është
ndërtimin arkitektonik të sallës. Ajo
shtatë unazash bashkëqendrore të
bordhurë të hollë nga njëra tjetra,
me nga të tjerat, por në harmoni m
to dy janë të zbukuruara me motive
motive gjeometrike dhe dy me figura
zore. Unaza e parë ka degë të valë
myshku dhe shërben si buzinë e tërë
za e dytë ka medalione të formuara
gërshetuara që kanë në brendësi
kafshësh; unaza e tretë dy palë rrat
hen në mënyrë të vazhdueshme dh
vetëm nga bazamentet e kolonave të
e katërt është e ngjashme me të dy
dhe natyrë dekori, madje dhe jash
Unaza e pestë përsërit të parën ndë
tretën, duke u ndërprerë dhe ajo ng
za e shtatë zë gjithë zonën rreth va
het nga tre rradhë rrathësh të gërsl

Dy skena me figura kafshësh n
të dorës së parë janë pranë hyrjes
E para është në unazat 4 dhe 5 dh
ristinë, e dyta në unazën e shtatë pa

75) S. Anamali, Veп. cit. 337

DO NOT COPY

Nga analiza e mënyrës së ndërtimit figurativ dhe lidhja me elementë arkitektonikë dhe brendësinë, mozaiku rezulton të jetë ndërtuar njëherësh dhe se është bërë mbas ndërtesës, pavarësisht se mund t'i jetë nënshtruar restaurimeve.

Lidhur me kohën e ndërtimit, duke u nisur nga forma planimetrike mozaiku në tërësi[77] dhe forma e kapiteleve të tipit impost kapitel jonik[78], baptisteri duket se është ndërtuar në mezin e shek. VI. Në se do të vështronim teknikën e ndërtimit të mureve kryesisht me gurë dhe përpunimin karakteristik të fugave, rezulton që baptisteri është ndërtuar në të njëjtën periudhë kohe me bazilikën e madhe të Butrintit dhe nga e njëjta atelje. Dekori i baptisterit flet për një nivel ekonomiko-shoqëror dhe më të lartë të qytetit, pra një ngritje të tij;

Salla në veri të baptisterit ka planimetri që shmanget pak nga katërkëndëshi këndrejtë. Ajo lidhet me portën veriore të baptisterit dhe ka hyrjen në murin e vet verior. Si muri lindor edhe ai perëndimor kanë nga një pilastër, që ndajnë nëpërmjet një bordure dyshemenë e mozaikut në dy pjesë. Në të katër anët e dhomës kalon një bordurë e njëjtë me atë të sallës së pagëzimit. Paneli verior ka një rreze me rrathë që ndërthuren me motive në formë sopate dhe fushën me figura gjysmëhelike e ndonjë simbol kulti. Paneli tjetër e ka brezin kufizues me pallonj me anë në mes, me çifte që vijon në tërë shtrirjen e brezit. Fusha e këtij paneli është e ndarë në mes. Pjesa perëndimore ka dekor gjeometrik me shpend në mes kuadrateve, pjesa tjetër me dekor sopatash përballë njëra tjetrës në rresht që alternohen. Duke vlerësuar këtë mozaik vërehet se ai është në nivel më të ulët artistik. Për datimin e tij arkitektura nuk ofron të dhëna sepse muret janë në nivel shumë të ulët dhe nuk mund të vihen në lidhje me muret e sallës së pagëzimit, duke u nisur nga mbetjet ne mendojmë se është një ndërtim i shtuar më vonë sallës së pagëzimit për qëllime ndihmëse.

Në aspektin tipologjik baptisteri është i një skeme të ndërmjetme. Ai afron me sallat me planimetri rrethore ose poligonale si ato të Noçerës, Torçelos, Lateranit në Romë (Italì) dhe ato poligonale brenda një katrori me nike në qoshet si në Noçera, Breshia, Akuilea (Italì), Marseja, Frejus (Fra standinopojë, ishullin Kos[79] (Greqi) etj. Bu Butrintit dallohet nga to si për përmasat as për ndërtimin e brendshëm me dy rradhë ko mbulesën me qemerë.

KISHAT NJË NEFSHE

Krahas ndërtesave të këtyre dy tipeve janë edhe kishat njënefshe, të cilat duhe kenë qenë të pakta për vetë lehtësinë e tuarit dhe përmasat e vogla të tyre në e rasteve. Të tilla janë ajo në Zgërdhes Antigone Paleokastër (kisha jashtë mureve)

Kisha në Tiranë[80], ndërtuar në sallën të një banese të shek. II-III, kthyer në go në fillim të shek. IV. Ajo ruhet sot shumë e tuar dhe përbëhet nga naosi me absidë dha në anën perëndimore (Tab. VII). Ambiente rrethonin këto. Naosi (8 x 11,5 m) ka dysh shtruar me mozaik me motive fjeometrike narteksi (12,9 x 4 m) për aq sa gjykohet r mentet e ruajtura është i shtruar me mozaik tive gjeometrike, simbole të kultit dhe fig shësh. Gjatë kthimit të godinës në kishë j dorur tulla me kryqe të datueshme si të koh randorit Kostandin, kur akoma nuk ishte qartë tipologjia arkitekturale dhe kur mjaft në qendra të vogla ktheheshin në faltore. tet ndihmëse në anën veriore të ndërtesës j shtatur nga ato të banesës.

Kisha jashtë kështjellës së Paleokastrë bëhet prej narteksit, naosit dhe një shtesë në në anën veriore (Tab. VII). Gjurmë të qoshen juglindore flasin për një të tillë në Nga shtesa veriore ruhen muri nga lindja dh perëndimi. Narteksi (me përmasa 2.70 x 4.2 dhet me naosin nëpërmjet një porte nga e het vetëm shpatulla e majtë. Në naos ruh nga dyshemeja e shtruar me salla të mëdhe kuruara (0,43 x 0,24 x 0,03 m) dhe tulla të p ruara (0,64 x 0,38 x 0,03 m). Përpara absidë një pllakë prej guri ranor që ka shërbyer

77) Lidhjet më të mëdha i shohim me mozaikët e bazilikës 2 të Nikopolit. E. Kit-

DOMJTCOBY

DO NOT COPY

ment i tryezës së altarit. Edhe në këtë kishë niveli i dyshemesë së absidës është më i lartë se ai i naosit. Në muret jugor, verior dhe lindor, në pjesët rreth tryezës së altarit ruhen pjesë të një sofati prej muri 0,65 m të gjërë.

Muratura e kishës 0,60 m e gjërë është e ndërtuar me gurë lumi lidhur me llaç gëlqeror me ngjyrë të bardhë. Mbi dysheme u gjetën copra të shumta të mbulesës së dikurshme me tjegulla të çatisë, që flet për një rrëzim mbas braktisjes. Pranë kishës u gjetën mjaft vende që flet për përdorimin e saj si kishë të varrezës së kështjellës. Kjo gjë si dhe ndërtimi i thjeshtë planimetrik flasin për një kishë të hershme të shek. V.

Gjatë gërmimit u zbuluan dhe fragmente skulpture si një kolon me kapitel, pjesë të tryezës së altarit si dhe një copë e vogël nga pllakat e dikurshme të ikonostasit, të gdhendur me teknikën e trarorimit. Me interes është dhe zbukurimi me gjarpërinj e kryqe i pllakave të dyshemesë. Simboli i parë është një simbol ilir, prania e të cilit në një kishë flet për mbijetesë të besimeve më të vjetra nga ai kristian.

Saranda

Në qytetin e Sarandës, Ankiasmin e antikitetit të vonë që njihet si qendër peshkopale e Epirit të Vjetër, ruhen disa ndërtime të periudhës paleokristiane, ende të pa gërmuara tërësisht, këto janë rrënojat e kishës 40 shënjtorëve në kodrat mbi qytetin, bazilika prapa pallatit kulturës dhe një ndërtesë (nën godinën e P.T.T. nga e cila ruhet një ambient që mendohet të jetë transformuar si ndërtesë kulti në shek. IV-V.

Salla me mozaik në godinën e P.T.T.[82] e dalë në dritë në mënyrë të fragmentuar gjatë gërmimeve për ndërtimin e ri, paraqet një ambient të një godine të shek. III të erës sonë, në të cilën janë kryer, sipas arkeologëve që kryen gërmimet në të, një sërë ndërhyrjesh për transformimin në një ndërtesë kulti. Në këtë dhomë të mbiemëruar dhoma me delfinë janë gjetur fragmente skulp të shek. IV-VI, si dhe një mbishkrim flet për një presbiter. Krahas saj në tive të mozaikut janë gjetur pjesë vona. Të tilla janë mbishkrimet, medc në këndin verilindor dhe disa arni gjendjen e tanishme ndërtesa e ru parë të P.T.T. nuk jep mundësi për këto të dhëna.

Kisha e 40 shënjtorëve[83]. Prej pjesë të substrukturave sepse muret u rrëzuan gjatë luftës së dytë bot nument e njohim nga planimetria që ve[84] dhe ndonjë fotografi e botuar

Kemi të bëjmë me një ndërtesë mëdha të planit (37.40 x 24.0 m) dh në anën lindore me një absidë (Tab. VIII). Në planimetri kisha përl dhe narteksi. Narteksi është pak më rësia e kishës, dhe në anët veriore fundon me konka. Ai ka në lindje të që i mbështeten dhe mureve të nac anët më të gjata, ato veriore e nike-absida që me sa duket mbuloh re. Në vendtakimet e tyre, kishte pi duket mbuloheshin me hark ndërm kishte dhe në anën e naosit që ed lidheshin me harqe e mbi to të mbi e çatisë. Pallas[86] na kumton se në shës janë gjetur dhe dëshmi jo t rradhë kollonave dhe në këtë rast bënim me një bazilikë tre nefshe. K tu besuar sepse në të kundërtën h sit do të ishin mjaft të mëdha për lehtësi me kapriata druri. Në anët mureve gjatësore kishte nga një ku ndërtimi i së cilës mbetet i paqartë

Nën narteksin ndodhet kripta e sërë kthinash me varre dhe nden gjurmë të një rindërtimi të vonë n mbishkrim me tjegulla në trajtë friz tuar e kohës së vonë të Paleologëv i shek. XV[87]. E ngjashme me të ës

---

82) Dh. Buding — B. Korkuti, **Mozaikë të rinj të zbuluar në Onhezmin e Iashtë (Sa-**

kishën më të vjetër të fshatit rrënojë të Kamenicës, që e kemi datuar në shek. XIV[88]

Muret anësore të kishës kishin dritare në dy rradhë. Ato ishin ndërtuar në mënyrë të rregullt me gurë pak të punuar, e të lidhur me llaç gëlqereje.

Kisha është datuar nga Dygve në shek. VI[89]. Ajo i ka dhënë dhe emrin qëndrës së banuar – Sarandës. Siç tregojnë dhe rindërtimet e saj, kisha ka vazhduar të përdoret për një kohë të gjatë, rezultat i banimit të vazhdueshëm të trevës nga e njëjta popullsi.

Kisha trekonkshe në Antigone (Jerma e Gjirokastrës). Në rrënojat e Antigonesë, qendra më e madhe e antikitetit në luginën e Drinos kanë dalë në dritë nga gërmimet arkeologjike dy kisha paleokristiane: Më e rëndësishmja ndër to e zbuluar në vitin 1974 është kisha trekonkshe në skajin jugor të mureve të qytetit, e përfshirë në ndërtime të tjera.[90].

Në planimetri kisha përbëhet prej naosit (7.3 x x 5 m) dhe ambientit të altarit trekonkëshe, e gjërë në pjesën jo absidale sa naosi dhe 3.80 m gjatësi në drejtim të lindjes (Tab. VIII). Dy absida më të vogla krijohen në këtë mënyrë në anët veriore dhe jugore, ndërsa një më e madhe me gjërësi sa vetë e kishës në anën lindore, një këmbë më e lartë se dyshemeja e vet kishës. Ndërsa nga dyshemeja e dikurshme me pllaka guri e naosit ruhet vetëm një fragment në qoshen veriperëndimore, ambienti i altarit, me përjashtim të absidës lindore ka qenë i shtruar me mozaik që ruhet pak a shumë mirë.

Muret e kishës janë pak a shumë rreth 0,80 m të trashë dhe të ndërtuar me gurë të çrregullt lidhur me llaç gëlqereje, vetëm gurët e absidave janë të punuara në anën e jashtme. Në naos hyhet nga një portë e gjërë në anën perëndimore, në pragun e së cilës ruhen vrimat e kanatave të drunjta. Në pjesën më lindore të murit perëndimor është një sofat i ndërtuar më mirë. Gjatë gërmimit u gjetën pjesë të vogla suvaje të ngjyrosur si dhe fragmente me motive bimore të punuara në relief. Me interes janë dhe fragmentet e kolonave dhe pllakave të ikonostasit të dikurshëm që ndante ambientin e altarit nga naosi, gjurmë të të cilit ruhen dhe në pragun e gurtë të dyshemesë së shtruar me mozaik.

Kisha duhet të ketë qenë e mbuluar druri dhe këtë e sugjeron trashësia e pakë reve. Nga mbulesa me kube në formë çer e të tre konkave janë gjetur gurë çmërsi. gjetjet arkeologjike, motivet e përdorura në dhe dekori, kisha është datuar si e shek. V-V të veçanta paraqet mozaiku me figurën e drore antropomorfe-zoomorfe, të interpretu si paraqitja figurative e Shën Kristofor kokëq që përbën shembullin më të vjetër që njih

* * *

Nga studimet e derisotme, rezultat i kë arkeologjike të 15 vjetëve të fundit, është kri tablo e re më të dhëna të shumta. Kështu numente dhe në se do tju shtojmë atyre g rastit dhe ndërtimet ende të pagërmuara, monumenteve paleokristiane arrin në mbi ndodhen në gjithë territorin e vendit, si në e rëndësishme ashtu edhe në ato të dorës në bregdet e në brendësi të vendit. Në rr parë kemi qytetet-qendrat peshkopale, në mj me më shumë se një monument, më tej qe banuara buzë rrugëve të komunikacionit, si dorës së parë ashtu dhe degëve të tyre. Në tën kohë kemi ndërtime dhe në zonat e the në ato malore. Shumica e tyre janë faltore të shme por nuk mungojnë dhe ndërtime të n reve si në Arapaj, Goricë, Ballsh e Sarandë. numentet dëshmojnë për zhvillimin tërësor t dhe jo vetëm të qendrave kryesore e atyre br re, rezultat i zhvillimit të mirë ekonomiko-sho provincave ilire, i lidhjes së brendësisë me kryesore. Për tu vënë në dukje është dhe n përgjithësi i mirë i kësaj arkitekture, si dhe kurimores (skulpturë e mozaik), i cili vërehe qendrat kryesore ashtu dhe në ato të bre duke dëshmuar edhe për qënjen e atelieve t ta vendase.

Duke shqyrtuar në aspektin tipologjik mentet paleokristiane të vendit tonë shohin mi tipologjike, brenda tipologjisë së njohur t timeve kishtare të kësaj periudhe: bazilika, me me planimetri qëndrore dhe kisha njëne

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Bazilikat siç pamë edhe më lartë përbëjnë grupin më të rëndësishëm dhe më të madh në numur. Ato janë të tipit helenistik, trenfëshe, me çati druri e nefin qëndror më të lartë. Ecuria tipologjike e tyre është një rrugë zhvillimi nga shek. i IV në të VI. Nga parashtrimi i mësipërm i monumenteve rezulton se mund të ketë qenë mbuluar me qemere bazilika e akropolit të Butrintit. Në aspektin e organizimit të brendshëm, bazilikat tona në shumicën e rasteve kanë qenë me arkada mbi pilastra, të tilla janë ato të Tepes, Butrintit, Sarandës, Goricës, Bylisit, Paleokastrës. Në gjëndjen e sotme të studimeve dhe rrënojave, na rezulton me arkadë mbi shtylla vetëm bazilika e Amanties, ndërsa për ato të Arapajt, Lezhës, Mesaplikut, problemi mbetet i paqartë. Nga pjesët e gjetura në vend kuptohet që muri mbi harkadat ndarëse të nefeve që ngrihej më lartë kishte dritare njëshe ose dyshe me kolonë ndarëse e kapitel mbi të. Nga këto të fundit ruhet një numër i madh në Durrës, por janë gjetur dhe në Tepe, Amantie, Arapaj e gjetkë.

Për ndërtimin planimetrik e vëllimor të bazilikave është për të shënuar prezencën e transeptit të formuar qartë në Butrint, Finiq e tash së fundi dhe në Bylis. Rasti i bazilikës së Arapajt me ndërtimin e saj trikonkësh është i vetmi që njohim gjer më sot. Ky tip bazilikal duket se futet tek ne në fillim të shek. VI[93] dhe nuk kemi shëmbuj të tjerë. Ai gjason me bazilikat e Dodonës dhe Paramithisë të datuara në shek. VI.[94]

Një element tjetër që takohen gati në të gjitha bazilikat është narteksi. Ai mungon në Mesaplik, Butrint dhe Finiq, ndërsa në Arapaj naosi paraprihej drejtpërsëdrejti nga atriumi. Ndër bazilikat më të vona, si p.sh. në Amantie narteksi ka dhoma të tjera në të dy anët atë veriore e jugore që shërbejnë për diakonikonin.

Nga grupi i dytë që përmendëm më sipër, ai i ndërtimeve me planimetri qëndrore, kemi dy përfaqsuese Linin dhe baptisterin e Butrintit të ndryshëm edhe për nga vetë tipologjia në aspektin funksional. Kisha trekonkshe e Linit paraqitet mjaft e zhvilluar, me narteks, mjedis për katekumenet e baptister në anën jugore e diakonikon në atë veriore. Narteksi i saj paraprihet nga një atrium trekrahësh, brenda të cilit duhet të ketë patur një basen për funksione të kultit. Këtij grupi ka të ngjarë

Grupin e tretë e përbëjnë kisho
sigurisht do të kenë përbërë tipin më
për nga përmasat ashtu edhe nga le
mit. Krahas ndërtimeve që njohim si
Durrësit i vonë, Antigone, Paleokastë
qarta në Lekël, Apolloni, Zgërdhesl
për thjeshtësinë që çfaqet në përma
varfërinë e ndërtimit, ashtu edhe p
zbukurimores, bën përjashtim këtu t
gonesë.

Uniteti në zhvillimin e arkitekturë
vërehet në përdorimin e të njëjtit
nivelin e zbukurimores (tipet dhe m
rura), në teknikën e ndërtimit, mbe
studjuar këtë unitet edhe më mirë n
provincave tona, ndërmjet tyre si d
e tjera të Ballkanit e Mesdheut.

Si në gjithë ndërtimet e kohës,
me kërkesat e dogmës fetare ashtu
shëgiminë e shekujve të fundit të
mbivlerësimin e brendisë ndaj anës
numentet e vendit tonë në anën e jo
re të thjeshtë, e të rrafshët, ndërtuar
punuar gjithnjë të lidhur me llaç
përdorur një sasi të kufizuar tullash.
nik të ndërtuesve të tyre mund të d
e rregullta, njohja e ligjeve të stati
brin e shtytjeve të harkadave. Në ra
të Butrintit për këtë flet mbulesa m
qëzuar dhe ndërtimi planimetrik-vë
Në brendësi në të gjithë ndërtimet
arkitekturale kemi krijimin e një ha
shme karakteristike për arkitekturë
Në bazilikat kjo arrihet nëpërmjet
dave që theksojnë aksin gjatësor dh
vizjes përgjatë tij, ndërsa në ndër
metri qendrore nëpërmjet hapjes d
sore nëpër kolonadat rrethore; që
sinë më të gjërë. E vështruar njëhe
e tipologjisë, ndërtimit planimetrik
të arkitekturës dhe teknikën e ndërt
kitekturës paleokristiane në vendin
timet më të thjeshta në ato më të z
në anën kronologjike me zhvillimin
të vendit, ndërsa në anën shoqëro
kultit në një fe sunduese. Me int
vendosja në kohë e monumenteve

DO NOT COPY

monumenti. Shumica e tyre, si dhe pjesa më e madhe e gjetjeve të rastit, janë ndërtime të gjysmës së dytë të shek. V, gjysmës së parë të shek. VI. Megjithatë nuk mungojnë ndërtime të shek. IV (Tiranë, Skampin, Butrint), ashtu edhe të shk. V (Skampin, Lezhë, Durrës-Kapitele). Ndërtimi i tyre shpjegon dukuritë e përhapjes së krishterimit në territorin e vendit tonë nga qendrat kryesore nëpërmjet rrugëve kryesore në periferi, nga bregdeti në thellësi të vendit, si dhe mënjanimin e mbetjeve të paganizmit për një kohë të gjatë mbas kthimit të fesë së krishterë në fe zyrtare. Duhet thënë se nga periudha e parë kemi gjurmë të pakta dhe si pasojë e dëmtimeve të shumta nga dyndjet barbare të mezit të shek. V, si dhe nga fakti që ndërtimet e para kanë qenë të dobta.

Për krijimin e një brendësie karakteristike për arkitekturën e kësaj periudhe një rol të dorës së parë luante zbukurimorja. Në gjendjen e sotme të monumenteve mund të gjykohet tërësisht vetëm për skulpturën arkitekturale dhe për mozaikun e dyshemeve. Përsa i takon pikturës murale, për vetë shkallën e ruajtjes së rrënojave nuk ka të dhëna të plota. Janë gjetur vetëm fragmente suvaje të ngjyrosur në Skampin, Antigone, Paleokastër, Arapaj e Mesaplik që dëshmon për praninë e afreskut. Gjetje të kohës së fundit në amfiteatrin e Durrësit mund të na njohin më mirë në këtë drejtim.

Skulptura arkitekturale e ndërtimeve paleokristiane i takon kapiteleve, ikonostaseve dhe shtyllave të dritareve. Numëri i kapiteleve të zbuluara nëpërmjet gërmimeve dhe nga gjetje të rastit është i madh dhe me shtrirje në gjithë vendin, ku më shumë e ku më pak. Ndër ta ka të tillë që paraqesin punime me vlera të dorës së parë dhe që, nuk mbeten prapa nga kapitelet më të mirë të kohës, të tillë janë një numër i mirë i kapiteleve të gjetur në Durrës. Kapitelet për nga forma mund të grupohen në dy grupe kryesore. Në të parin hyjnë kapitelet me prejardhje nga ata të stilit korintik, ku gjethet e akanthit janë të stilizuara dhe me majë të mprehtë. Stilizimi shtrihet jo vetëm në gjethet në veçanti por edhe në ndërtimin e tyre në sipërfaqe të kapitelit duke u gdhendur kryesisht me trapan konturet e tyre. Të tillë takohen gati kudo por më të rëndësishmit dhe më të mëdhenjtë i takojmë në Durrës, ku nuk mungojnë kapitelet e quajtur Teodosianë të mepiramide të përmbysur me faqet të zbukur kryqe e motive bimore. Këta tipa kapitelesh gjysmës së dytë të shek. V dhe shek. të VI.

Në skulpturën arkitekturale një vend të zenë ikonostaset që shërbejnë për të ndarë tin e altarit përpara absidës në të cilën funksionet e kultit, nga salla ku ishin be Ikonostaset përbëheshin nga një rradhë mbi kapitelet e të cilave kalonte një arkit kuruar, ndërsa në pjesën e poshtme ndër kishte pllaka të zbukuruara që loznin rol parapeti. Pjesa ndërmjet tyre në këtë per hej me perde. Ikonostasi si gjithë ambient ishte në nivel pak më të lartë se salla. Ng met dhe zbulimet e deri sotme njohim ik e kishave të Skampinit, Linit, Amanties, By fragmente nga Butrinti e Durrësi.

Në trajtimin e brendësisë së këtyre nd shtresa me mozaik e dyshemesë loste një r rës së parë për vetë shtrirjen e tyre dhe sh rëshmërisë e zbukurimeve të përdorura. C dekorativ i sallave dhe ambienteve të sh mozaik i nënrendohet gjithnjë arkitekturës. nelet me mozaik janë të rrethuara me bu a shumë të gjëra, që përbëjnë në aspekti rues një tërësi dhe shkojnë përgjatë mureve Përgjithësisht kështu ndahen dhe panelet tjetri kur janë brenda së njëjtës sallë. Dek dorur është ai gjeometrik, bimor dhe shtaz përjashtim këto: mozaiku i Antigonesë d e Aparkeasit mitologjik, skena bukolike n dhe mozaikët e bazilikës së madhe të Bylis gjeometrik haset si në buzinat ashtu dhe në të tilla janë rrathët që ndërpriten, trek gërsheti etj. Motivet bimore janë të shum Përdoren si dredhëza, ashtu dhe degë rrush the e vile që bëjnë pjesë në simbolikën Këto mund të jenë të veçanta apo në s shpendë e kafshë, që përbëjnë motivet ng kafshëve mjaft e përdorur në mozaikun e të vonë. Skena të tilla si ato të baptistet trintit, bazilikës së Arapajt, e Bylisit, ajo së Linit përbëjnë vepra arti me vlera të parë.

Në se do të shqyrtohen prejardhja e të përdorura do të merrnin një vazhdimës

matikën e artit paleokristian. Në aspektin stilistik kemi një stilizim të mëtejshëm, skena të parafiksuara me karakter simbolik dhe përdorimin e kubikëve prej paste xhami që krijon ngjyra dhe efekte të reja.

Janë pikërisht qytetet e bregdetit, ato që kanë edhe në këtë periudhë zhvillimin më të madh të mozaikut, i cili megjithatë takohet dhe në brendësi. Kjo flet jo vetëm për një vazhdimësi të traditës por edhe për zhvillimin e zonave në brendësi të vendit. Shqyrtimi stilistik i mozaikut flet për qënien e një sërë ateljeve të cilat veprojnë në kohë të caktuara në zona të caktuara, siç vërehet në zonat e Durrësit, Ohrit, Epirit të Vjetër.[95]

Siç rezulton nga studimi i ndërt
stiane, provincat e Prevalit dhe dy E
gjysmën e dytë të shek. V e gjysmën
VI një zhvillim të mirë dhe unitar p
nga provincat e tjera të perandoris
mundur përballimin e sulmeve të pa
rimëkëmbjen në gjysmën e dytë të sh
bazë trashëgimie e tradite u bë e m
sa e mjaft ndërtimeve paleokristiane
hershme dhe vijushmëria e traditës r
dimi i monumenteve paleokristiane nd
çimin e mjaft problemeve të nivelit
shoqërisë ilire në shekujt e fundit të

DO NOT COPY

DO NOT COPY



BUTRINT –
BAZILIKA E AKRO

SKAMPIN BAZILIKA E TEPES

0 1 2 3 4 5m



DO NOT COPY



DO NOT COPY

FOINIKE



BUTRINT - BAZILIKA E MADHE



DO NOT COPY



DO NOT COPY



PALEOKASTER-BAZILIKA

(SIPAS A. BAÇE)

GORICE



DO NOT COPY

LINI

(SIPAS S. ANAMALI)



BUTRINT — BAPTISTE



DO NOT COPY



PALEOKASTER —
KISHA JASHTE MURIT
(SIPAS A. BAÇE)

DO NOT COPY



ANTIGONE – KISHA TRE

(SIPAS DH. BUOINA)



SARANDE – KISHA E 40 SHEN

(SIPAS E. DUYGVE)

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE PALEOCHRETIENNE EN ALBANIE

RESUME

L'évolution de l'Illyrie au cours de la Basse Antiquité, témoignée entre autres par le nombre de fortifications et leur niveau technique, apparait aussi dans l'architecture de culte. En ce qui concerne l'organisation administrative et religieuse les régions de l'Albanie s'englobèrent dans la préfecture de l'Illyrie, dans les provinces de l'Ancien Epire avec Nikopoje comme métropole, dans le Nouvel Epire avec Dyrrah et dans Prévolitane avec Shkodra. Les trois métropoles mentionnées, quant à leur vie religieuse, étaient administrées par le pape de Rome, notamment par l'intermédiaire du vicaire de Théssalonique. Cette forme d'organisation continua jusqu'à l'année 484 quand Thessalonique et toutes les provinces de l'Illyrie se rangèrent du côté de Costandinople, durant le règne des empereurs Zenan (474-489) et Anastas (491-518) qui entravèrent les relations avec Rome. Le vicariat se renouvella formellement sous l'empereur Justinian (527-565) qui, en 535, créa l'archevêché de Justiniana Prima, lequel partageait cette fonction avec celui de Thessalonique. Entre temps, Rome aussi exerçait directement sur eux son pouvoir. Dès cette époque-là la métropole de Prévolitane (Shkodra) dépendait de Justiniana Prima. Dans la documentation écrite, conservée jusqu'à nos jours, ne se reflètent pas tous les archevêchés des villes mentionnées par Hierokle, mais nous pensons qu'il y en a eu dans toutes les villes. D'après une loi de l'empereur Zenan (474--475), qui nous est donnée par le Codex Justinianus, chaque ville devait avoir son propre évêque. Cette organisation administrative appartient sans doute aux réformes de Dioclecian (284--305) qui s'exercèrent jusqu'aux premières années du règne de Constantin (324-337).

Les premières fouilles archéologiques dans ce domaine avant la Deuxième Guerre Mondiale ont été effectuées par L. Ugolini, qui fouilla le baptistère de Butrint, la basilique et l'acropole, la basilique de Finiq et effectua des sondages dans l'église à trois conques de Butrint. Après un long travail d'étude, vers la fin des années 60 on passa aux fouilles archéologiques dans différents endroits, qui ont apporté de bons résultats dans le domaine de l'architecture poléochrétienne. A Kabash de Pukë, à Lezhe à Grazhdan etc. A Durrës découverts beaucoup de fragments de sculptures arc ques dont le grand nombre et les différents qualités té d'une abondance de monuments et de l'importance de dans la Basse Antiquité.

Pour les constructions paléochrétiennes on prit p dèle deux des types les plus répandus de l'architecture des deux derniers siècles de l'empire, les basiliques et tructions à planimétrie centrale. Leur aménagement à fonctionnels de culte ainsi que les conceptions architec de l'époque apportèrent les modifications respectives a construction de planimétrie et de volume et dans le tion. De pair à ces deux types principaux on a ég construit le simple temple à une nef.

Les basiliques

Les basiliques étaient les meilleures constructio pres à des fin de culte. Elles pouvaient se faire c facilement et assez spacieuses pour que lors des cé religieuses y participent un grand nombre de croyants

La basilique de l'Acropole à Butrint *sise au pl point de la partie Est de son acropole, sur un petit rocheux, se présente transformée et soumise à quelqu ses de construction. La première construction, la b paléochrétienne, représente une construction à trois ne un narthex situé à l'Ouest et une ambiance près méridional.*

Para se të ndërtohej manastiri dhe kish Kozmait aty pranë nga ana jugore ka pas kisha tjetër më e hershme ajo e Shën Mër përket çerekut të fundit të shek. XVIII. Në shkrim të skalitur greqisht mbi një pllakë murosur në anën veriore të absidës së ja kësaj kishe thuhet: «Është pikturuar ky hyjshëm me kontributin e të gjithëhirshmit N tit të Beratit Josaf, me shpenzimet dhe mu të gjithë të krishterëve, priftër dhe laikë 17 30.[21]. (Fig. 5-6). Fatkeqësisht ky ndërtim arkitektoniko-artistike, për shkak të pozitës breg të lumit Seman, është fundosur e kt kohe (v. 1935) në rrënoja prej ujrave dhe meve të ndryshme të këtij lumi. Për konstr mbishkrimet dhe mbeturinat e pikturave me ka qenë pajisur kjo kishë, edhe pse rrënojë, venë në mbrojtje shtetërore qysh në vitin pjesë përbërëse e ansamblit monumental q het bashkë me mbeturinat e manastirit dhe Shën Kozmait[22]. Edhe sot në pjesën e m

DO NOT COPY



Fig. 7

kanë ngelur mbi tokë nga kisha e Shën Mërisë, veç absidës pjesore (Fig. 7) dhe qemereve të dritareve, vërehen qartë aureolat e shenjtorëve të pikturuar, që ndodhen të mbuluara nga dheu.

Vlera artistike. Përveç vlerave historike dhe arkitektonike të ansamblit në përgjithësi, në bazilikën e shën Kozmait ruhen edhe punime me vlerë artistike.

ndërtua kjo bazilikë, pikërisht në viti
figuron e skalitur në krye të tij. Në
përdorur motive e trajta nga më të
nga ato gjeometrike e bimore deri n
Edhe pse në këtë punim artistik të
dru është zbatuar teknika e tejshp
ikonostasi nuk bart vlera të kategori
sa i përket nivelit të lartë artistik, siç
nostaset e Beratit dhe të Korçës,
apo Sopikut (Gjirokastër) etj. Nga të
ftuar del se ikonostasit i është bërë
vitin 1942.

Të një niveli relativisht të dobë
rradhët e ikonave me të cilat është
stasi. Në pjesën e sipërme sot qënc
kurse në rreshtin e parë janë 10 ikor
të ndryshme. Përveç këtyre ka edhe i
me përmasa më të vogla, të mbës
nostas, që ndoshta janë sjellë
më e vjetër e rrënuar e shën Mëris
pjesën më të madhe ikonat janë të
vonë.

Jo për vlerën artistike, por për
mit dallohet një ikonë e pikturuar n
ne e naive, por që si një tabllo kon
disa pamje nga jeta e Kozma Etoli
veçantë është dhe një gravurë e v
proskinitar, që është vepër e një gr
Kalinikos dhe që mban vitin e krijim
Në këtë punim të gravuruar në plur
bukur disa pamje nga jeta dhe vep
mait, kurse në të katër anët rrethoh
më të vogla me subjekte të veçantc

Në brendësi kjo bazilikë ka q
por me kohë këto piktura të dëmtu
net, ujrat e lagështira, janë sherb
rreth 9 kisha të krahinës së Myzeqes
nga piktorët grabovarë të familje
Jani, Nauni, Nikolla). Ka shumë m
prej tyre të këtë qenë, edhe autori i

Mjeshtrat që e kanë ndërtuar kë
lënë portretet e tyre të skalitura në c
dur në dru gjendet edhe një shqipc
altarit, kurse mbi frontonin e këmb
së cilës ka ndryshuar nga një kohë
kthisur një portret në gur, ku thuhet
sit kanë dashur të portretizojnë bas

DO NOT COPY

kthisur nëpër mure, si të bazilikës, ashtu edhe tek pjesët e ngelura të konakëve të manastirit, me rozeta e motive të tjera, ndonjë kolonë e kapitel etj.

Tregojnë se në trajtën e kishës ka qenë veshur koka e Shën Kozmait me ar ose argjend nga Ali Pashë Tepelena, dhe kjo kokë me gjithë to qenka marrë nga pushtuesit e huaj si duket gjatë luftës së parë botërore. Thuhet edhe se Ali Pasha i paskësh dënuar ustallarët e parë, që nuk e ndërtuan dot kishën sipas shëmbëlltyrës së kokës që ai kishte sajuar me ar.[24]

Punimet e restaurimit për çlirimin e plotë të monumentit nga dherat dhe konsolidimin e mbrojtjen e tij, si edhe për nxjerrjen në pah dhe pastrimin e konsolidimin e pikturave dhe të ikonostasit, do të ndihmojnë mjaft në vlerësimin edhe më të madh të këtij ansambli, që flet qartë edhe për traditat tona në lëmin e arkitekturës dhe artit.





Fig. 9

* * *

Së fundi, është rasti të sqarojmë sh
tri çështje, që janë të lidhura me rolin, pë
etnike dhe reliket e Kozma Etolit, të cilat
të shkëputura nga ansambli që po trajto
që mendojmë se nuk janë pa interes.

Kozma Etoli ka luajtur rolin e një për
shkollave greke, në një periudhë kur ende
fituar indipendenca greke, kur gjuha g
shek. XVIII konsiderohej si gjuhë e kultur
kishës për të gjithë ortodoksët e Ballkan
vetmja gjuhë e pranueshme nga Patrikana
Stambollit në marrëveshje me Sulltanin e
risë Osmane.

Nga një autor i shek. XIX mësojmë se
kishte për mision të çkishëronte në emër
kanës cilindo që do të dëshironte edhe të f
vllahisht, qoftë shqip[25]. Po kështu, sipas
dit,[26] Kozmai i ka luftuar përpjekjet për
kishën në gjuhën amtare të vllehët. Një gj
siç është shprehur me të drejtë dhe Prof. D
Shuteriqi, mund ta ketë bërë edhe ndër n
që e shpalli shënjt Kozmanë, ishte kundë
të gjuhës amtare nga ballkanasit, të pakt

të saj, po të greqishtes[27]. Megjithkëto nuk duhet mohuar edhe një farë kontributi i tij, që u dha tërthorazi për arsimimin e një pjese të popullatës tonë, qoftë edhe përmes shkollave në gjuhën greke.

Një problem i diskutueshëm na duket se është çështja e përkatësisë etnike të Kozmajt. Në përgjithësi në traditën popullore Kozmai njihet me origjinë greke. Edhe në Historinë e Shqipërisë përmendet si murg grek nga Etolia[28], që siç dihet është krahinë kufitare me krahinën çame të Prevezës e Artës. Mirëpo hulumtimet në burime të tjera vënë në dyshim këtë përkatësi etnike. Kështu, p.sh. studjuesi ynë Ilo Mitkë Qafëzezi, në dy shkrime të tij, e përmend «çami shqipëtar shën Kozma Isapostuli» apo e cilëson si «misionar pedagog çam»[29]. Nuk dimë se ku mbështetet ky autor dhe tani për tani as që jemi në gjendje të verifikojmë vërtetësinë e këtij pohimi, por kemi edhe një dëshmi tjetër me interes. Një autor tjetër na jep këtë hollësi: «Shqipëria në atë kohë ishte në gjendje paditurie. Fjalimi i tij (i Kozmait – S.A.) bëhej në gjuhën e folur dhe turma shpejtonte për ta dëgjuar»[30]. Pra, kuptohet se ai u fliste shqip.

Thamë më sipër se murgu Kozma më tepër shëtiti e predikoi në ish qarkun e Beratit, autor gabimisht e quan fare beratas[31]

Pasi u ngrit manastiri dhe kishmait (përuruar më 1815) me urdhër bë transferimi i kufomës nga kisha e Mërisë, ku e kishin varrosur, pranë Si rrjedhojë e gërryerjeve dhe shshkaktuara nga prurjet e Semanit, ntruallin midis kishës së vjetër dhe një kishëzë tjetër modeste ku u venKozmait[32]. Edhe sot gjendet kthina emjedis me varrin e imagjinuar (kenoku qenë varrosur eshtrat e Kozmait vendoseshin në arkivolin prej druxhamllëk në trajtën e një sarkofagu, në naosin e kishës së Shën Kozmait.

Për praninë e relikeve të Kozmai e Kolkondasit, flet edhe Leon Rey qnjë botim të tij[33]. Një fakt i tillë fihistorikun e fshatit hartuar më 1962qenë konstatuar me kohë edhe ngashkrimi. Dëshminë e saktë të pranislikeve e ka ruajtur tradita popullorenga një brez në tjetrin.

27) Dh. S. Shuteriqi, **Nëpër shekujt letrarë,** fq. 86.
28) **Historia e Shqipërisë,** I, 1959, fq. 430.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB I



1

Planimetria shk 1 100



4

Pamje perendimore shk 1 100



2

Pamje veriore shk 100



5

Pamje terthore shk 1 100

Plani shk 1 100





DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

L'ENSEMBLE HISTORIQUE ET ARCHITECTONIQUE-ARTISTIQUE DE KOLKONDAS-FIER.

Il est question de l'ensemble monumental sis près de la ville de Fier, qui à l'heure actuelle n'existe que partiellement. La construction du monastère et de l'église de Kolkondas a été faite pendant la deuxième décennie du XIXe sc. dans des conditions données avec la demande et l'aide du dominateur du pashalik du sud, Ali Pasha Tepelena et à l'honneur de Kozma Etole.

Au début l'auteur nous donne brièvement des données historiques sur Kozma Etole, sur ses relations avec Ali Pasha Tepelena, ainsi que sur les conditions dans lesquelles le dominateur s'interesse à construire cet ensemble. En reproduisant le contenu complet de ses deux littres adressées aux habitants de Berat aux cours des années 1813-1814, qui ont trait à cette construcion, l'auteur décrit en même temps le monastère tel qu'il était autrefois et à l'état actuel.

D'après les matériaux exposés dans cet article, il résulte que ce monastère était un des plus grands de notre pays. Il était à un étage et avait 60 chambres. Au premier étage habitaient les moines et les serviteurs du monastère, dormaient les croyants et les marchands lors des foires; au rez-de-chaussée il y avai des étables et des dépôts. Pour sa construction, en une période relativement courte de plus d'un an (1814-1815), se mobilisa toute la population de la région de Berat, Lushnje, Fier et également celle des autres régions côtières depuis le fleuve Shkumbin jusqu'à la côte Ionienne.

Avec la construction de cet ensemble, Ali Pacha ordonna que Kolkondas fusse le centre de la direction religieuse contrôlant une large zone administrative. Par l'ordre d'Ali Pacha on céda à ce monastère des terres réparties dans plusieurs villages. Ceci faisait que la population fusse doublement exploité par les féodaux et par l'église. Entre temps à Kolkondas fut ouverte une école primaire où l'on enseignait en grecque et en turque et qui était à cette époque, la plus grande de la région. Dans l'internant du monastère étaient logés environ 100 leçons d'albanais, ce qui causa des poursu ments des maîtres.

Une bonne partie de l'article se rapp de l'église Saint Cosmas laquelle à part écroulé par les alluvions du fleuve de Sema vement en bon état, et de la plus ancier Dame qui n'existe qu'en était de ruines. L'. mas est du style de la basilique à coupole des basiliques ordinaires, elle se compose d te église semble être assez développée d la planimétrie et du volume. Sa plani sous la forme d'une croix circonscrite. A croix en évidence et les parties entre elles elle ressemble à une construction pyramidc celle des églises de la période avant l'oc plus proche exemple est celui de l'église

L'église de Notre Dame malgré son sa construction, ses inscriptions et les r oeuvres de l'année 1782 d'après l'inscrip est mise aussi sous la protection de l'Etat, intégrante de l'ensemble monumental avec nastère et de l'église de Saint Cosmas.

A part les valeurs historiques et l'ensemble en général, la basilique de Sa des travaux de valeur artistique comme p. bois qui a été sculptée en 1835, donc 20 struction de la basilique. L'auteur s'arrête l'analyser minutieusement. L'iconostase est à des traits différents, depuis ceux géom jusqu'à ceux zoomorphes. Mais l'auteur s l'utilisation de la technique de perforatio tistique, ne se range pas aux niveaux c telles les iconostases de Berat, de Korçe, ou de Sopik (Gjirokastër).

Enfin l'auteur traite brièvement trois q

DO NOT COPY

Nr. 2

monume

Emin RIZA

TIPOLOGJIA E BANESËS QYTETARE NË RAPORT ME FORMULIMIN E AMBIENTEVE, TË ELEMENTEVE ARKITEKTONIKË DHE TEKNIKËN E NDËRTIMIT

Tipologjia e banesës në përgjithësi, dhe asaj qytetare në veçanti, si shprehëse e karakteristikave thelbësore të kompozimit planimetriko-volumor, shfaqet me një zhvillim të qartë në kohë. Ky zhvillim është pasqyrim i kushteve të dhëna ekonomiko-shoqërore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt, apo tërthorazi, në tiparet e banesës. Kompozimi, si tipari më i qënësishëm i banesës, bëhet për pasojë bartësi më i drejtpërdrejtë i mënyrës së jetesës.

Larmia tipologjike e banesës, në një periudhë të caktuar, shkallët e ndryshme të prirjeve njësuese apo diverguese në hapësirë e kohë dhe formulimi i saj arkitektoniko-konstruktiv, janë tregues të rëndësishëm për të kaluar nga dëshmia arkitektonike në realitetin historiko-shoqëror të një periudhe të caktuar. Por nëse do të qëndronin vetëm te kompozimi, sado parësor qoftë ai, do të humbisnin faktorë të tjerë, deri diku të rëndësishëm, për të ndjekur tiparet dhe karakterin e banesës në zhvillimin e saj historik. Kompozimi i banesës i kuptuar si bashkëmarrëdhënje funksionale e ambienteve të ndryshme në plan dhe në volum, presupozon kristalizimin e formulimit të këtyre ambienteve, njohjen e një repertori të caktuar të elekëtyre përbërësve është i lidhur në shkallë shme me faktorë të sferës ekonomiko-shoq nivelit të arritjeve teknike të kohës, të sh tetike si dhe të natyrës së materialeve n të llojit dhe shkallës së përpunimit të tyre.

Qëllimi i këtij artikulli është përpjekja analizë të bashkëmarrëdhënjeve ndërmjet mit dhe tre përbërësve kryesor, të sipërpë Këto raporte do të shihen kryesisht, duke dinamikën e zhvillimit të këtyre tre përbërë ralelisht me atë të kompozimit. Kjo përqas lejojë të nxirren përfundime që lidhen me e vartësisë, apo pavarësisë ndërmjet tyre, n lën e dukurive njësuese, apo ndryshimev da së njëjtës tipologji, si dhe tipeve të n brenda një kuadri të caktuar historik. Sip në artikull do të preken edhe marrëdhëni mjet formulimit të ambienteve të banesës arkitektoniko-konstruktiv si dhe materialeve nikës së ndërtimit. Kjo përpjekje do të i ndihmesë edhe për restaurimin e kësaj gji tektonike, sepse do të thellonte shkallën e së këtyre dukurive, e për pasojë do të le ndërhyrje më të mbështetura.

DO NOT COPY

mi shek. XX). Tashmë janë të njohura,[1]) ndryshimet thelbësore ndërmjet tipologjisë së banesave të këtyre dy grupeve, prandaj në shqyrtimin e problemit që do të trajtojmë, do të prekim veças dukuritë që n'a interesojnë, sepse grupet e përmendura paraqesin dallime cilësore.

Tipologjia e banesës, praktikisht shfaqet nëpërmjet një sërë kompozimesh të një repertori të caktuar ambientesh. Format e ndryshme të kompozimit, brenda parimesh të njëjta kompozicionale, paraqesin variantet e ndryshme të një tipi. Prandaj, kur të jetë rasti për të bërë krahasime të tipave të ndryshëm, këto do të bëhen përkatësiht me variantet përgjegjës, sipas shkallës së zhvillimit të tyre.

Le të shohim së pari marrëdhëniet ndërmjet tipologjisë dhe formulimit të ambienteve të banesës për periudhën e feudalizmit të vonë. Duke pasur parasysh të katër tipat e banesës qytetare të kësaj periudhe, banesën tiranase, banesën me hajat, banesën me çardak dhe atë gjirokastrite, si dhe zgjidhjet e veçanta, vërejmë se për ambientet e thjeshtë, shihet në përgjithësi një afëri e dallueshme në formulimin e tyre, pavarësisht nga tipi i banesës, përbërës të të cilit ata janë. Kështu ahuri, i cili është një ambient i përhapur gjerësisht në tipologjinë e banesës qytetare, që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë, në trajtimin e tij nuk paraqet asnjë dallim që të lidhet me tipologjinë e banesës. Kjo natyrisht është pasojë dhe e funksionit të thjeshtë të këtij ambienti. Edhe tremet e hapura, si hajatet dhe çardaqet, në trajtimin e tyre qoftë të thjeshtë, dmth. pa sipërfaqet e paracaktuara për qëndrim, qoftë edhe me këto, paraqesin një njësi të dalluar. Mjaft të krahasojmë qoshqet e banesës me çardak me ato të banesës me hajat (fig. 1), si dhe të banesës gjirokastrite. Vendosja në kompozim, si dhe trajtimi i këtyre qoshqeve me ngritjen karakteristike nga rrafshi i dyshemesë së pjesës ndërlidhëse të tremeve të hapura, është e njëjtë.

Shtëpia e zjarrit paraqet gjithashtu afëri të dalluara në mbarë tipologjinë e banesës qytetare shqiptare. Por këtu duhet mbajtur parasysh dukuria e shpërbërjes së funksioneve të këtij ambienti, i cili duke kaluar nga variantet e thjeshtë në të zhvilluarit, shkallërisht humbet parësinë fuksionale, dhe për pasoj vendin e rëndësishëm në kompozim. Hu-



Fig. 1

het se në tipat krahasimisht të pazhv
nesën tiranase dhe atë me hajat, s
ka paralele të dalluara. Përkundrazi
lluarë, e vecanërisht në variantet e

DO NOT COPY

ndeshim rrallë edhe në disa shembuj të banesës me çardak. Pra shtëpia e zjarrit ka një lidhje relative me tipin e banesës si dhe me variantet e saj. Ajo në tipat më primitivë dhe në përgjithësi në variantet e thjeshtë të çdo tipi, është me shumë funksione dhe mjaft e spikatur në kompozim[2].

Siç dihet oda, përbën një prej njësive themelore të banesës. Numëri i këtyre njësive në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare është i ndryshëm sipas varianteve. Lidhur me këtë ambient, si brenda të njëjtit tip ashtu edhe ndërmjet tipave të ndryshëm, vërejmë një aféri të dalluar përsa i përket kompozimit të odës si dhe paisjeve dhe orendive të palëvizshme, si pjesë e arkitekturës së banesës. Kompozimi i odës, në banesën qytetare shqiptare, duke përfshirë këtu edhe odën e miqve, paraqet një njësi të spikatur, pa qenë e lidhur ngushtë me tipologjinë e banesës. Qënia pothuaj konstante e elementeve të tillë, si kompleksi musandër--trapazan, dollapët e murit e kamaret, sergjenet, oxhaku dhe shpesh rrafshe të ngritur për sajimin e mindereve si dhe vendosja e këtyre përbërësve, thuajse në të njëjtat vende në kompozimin e odës tregojnë qartë për njësinë e dalluar të odës në banesën qytetare shqiptare. Përjashtime bëjnë disa oda miqsh[3] të aristokracisë feudale, të cilat janë trajtuar me tre volume: qoshkun, volumin qëndror dhe atë të kompleksit musandër – trapazan, të cilat shkëputen disi nga kompozimet e zakonshme, por në llojin e tyre janë të njëjtë në tipa të ndryshëm. Por kjo dukuri lidhet vetëm me kompozimin, ndërsa trajtimi dekorativ i elementeve të përmendur, dhe i përbërësve të tjerë të odës si dyer, dritare, tavan etj, paraqet ndryshime të rëndësishme ndërmjet varianteve të një tipi, si dhe ndërmjet tipeve të ndryshme. Këto ndryshime lidhen si me shkallët e ndryshme të ngarkesës dekorative ashtu edhe me tiparet e këtij përpunimi. Ndryshimet e ngarkesës dekorative brenda një tipi të cilat shkojnë në rritje, paralelisht me zhvillimin e varianteve të ndryshëm, janë shprehëse të drejtpërdrejta të diferencimit klasor të shoqërisë qytetare. Ndërsa ndryshimet e kësaj ngarkese, ndërmjet tipave të ndryshëm, shprehin nivelet e ndryshme të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të qëndrave të ndryshme qytetare. Për arsyet e mësipërme ndeshim në një mori shembujsh me diferencime të theksuara në trajtimin dekorativ, ndërmjet varianteve të thje-

ndeshim në vepra të vërteta të arteve të apli
pjesë përbërëse së odës së miqve. Ndryshim
mjet ornamentikës së ngarkuar dhe me arritje
nuara të banesave të zhvilluara të Shkodrës,
rokastrës, nga ato të qendrave të Shqip
Mesme janë shembull tregues, i ndikimit të
së zhvillimit ekonomiko-shoqëror në pasurinë
mentikës.

Fillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve kc
në vendin tonë, i cili fillon të pasqyrohet në
rreth mesit të shek. XIX, edhe me lindjen e n
ri banese, shoqërohet me njësimin e theksuc
tëm në planin tipologjik, por edhe në atë të
zimit dhe përpunimit të brendësisë së am
formuese të banesës. Dallimet lokale vinë e
ndërsa diferencimi klasor në ambientet e
shfaqet kryesisht me përmasat dhe materialet
timit. Mobilimi i brendshëm, në dallim nga ti
tradicionale, ku vetë banesa përfshinte edhe
të, si pjesë organike e saj, lejonte kufij të g
llimesh ndërmjet klasave dhe shtresave të n
shoqërore.

Përfundimisht lidhur me marrëdhëniet
kompozimit dhe njësive formuese të banesë
të pohohet se formulimi i këtyre të fundit, n
kompozicional, në përgjithësi paraqet njësi
lluar. Rrjedhimisht nuk ka ndërvartësi të ng
të drejtpërdrejtë ndërmjet tyre. Për t'u
është edhe konstatimi se kompozimi i bane
raqitet më dinamik, pra me një zhvillim krah
më të shpejtë në kohë, sesa kompozimi d
timi i brendësive të ambienteve formuese t

Elementet arkitektonike paraqesin një
të rëndësishëm të banesës, të cilët në rrje
kohës kanë evolucionin e tyre. Ky evolucio
qet në dy aspekte. I pari lidhet me formën
ndërsa i dyti me trajtimin dekorativ. Në pë
në evolucionin e elementeve arkitektonikë
zhvillim. Ashtu si edhe në kompozimin e bane
atë të njësive të saja formuese, arritjet e për
në një fazë të zhvillimit të shoqërisë qytet
përhapen njëherazi në mbarë tipologjinë e b
Shkaku duhet kërkuar në diferencimin klasc
bën që shtresat e varfra të ruajnë, si skemat
kompozicionale, ashtu edhe arritjet më të l
të elementeve arkitektonikë, sepse janë më
sisht të arritshme nga pikpamja ekonomike.

DO NOT COPY





Fi

shpejtimin e zhvillimit të elementeve arkitektonike. Studimet e derisotme, të cilat ende nuk janë shtrirë plotësisht në evolucionin e elementeve arkitektonikë mbi baza ndërtipologjike, nuk lejojnë të vendoset qartë morfologjia e këtyre elementeve dhe aq më pak të ndiqen kufijt kohorë të këtyre ndryshimeve. Megjithkëtë vrojtimet dhe studimet e derisotme lejojnë që të vihen në dukje këto dy pohime. Së pari, tiparet e elementeve arkitektonikë, pësojnë një ndryshim të dukshëm, me lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste, duke u shkëputur kështu nga tipologjia e vjetër. Së dyti, brenda tipologjisë tradicionale, ndryshimet më të dukshme në elementet e ndryshëm arkitektonikë, fillojnë aty nga fundi i shek. XVIII, apo fillimi i shek. XIX. Me kalimin e kohës, deri rreth mesit të shek. XIX, këto ndryshime

pazan, oxhakët dhe shkallët. Këta
rëfilltë funksionalë, mbajnë edhe n
shme dekorative, të cilat shprehen
kompleksin musandër-trapazan dh
odave të miqve.

Dritaria paraqet një element të
çdo ambient, dhe në funksion të tij
sa, numër dhe në trajtimin e saj.
bërë tashmë e njohur banesa qyte
lidhet me formacionin feudal të sh
përdhe është e pabanuar, duke u n
entet ndihmës, që kërkojnë një n
Këta ambiente ndihmëse, thuajse
funksione i gjejmë edhe në banes
hajat. Dritaret e këtyre ambienteve
gjithë tipologjinë e banesës qytet
riudhe me një njësi të theksuar

DO NOT COPY



Fig. 3

shoqëror. Deri aty rreth fillimit të shek. XIX kur xhami ishte një material i rrallë, dritaret e ambienteve të banimit, përgjithësisht siguroheshin me një rrjetë druri, apo metalike, ndërsa mbyllja e tyre arrihej nëpërmjet dy kapakësh prej druri, me rrotullim rreth akesh vertikale. Në muret e gurit, duke përfituar nga trashësia e tyre, këta kapakë hapeshin nga brenda, ndërsa në strukturat prej druri, me mbushje apo veshje, hapeshin nga jashtë (fig. 3), për të lënë të pastër sipërfaqen e qëndrimit në ballë të odës, e cila paraqiste dhe vendin më të parapëlqyer. Në shtresat e pasura të popullsisë, sipas dëshmive të derisotme[4], kryesisht në odat e miqve, krahas dri-

thjeshtat e deri te ato tepër të ndërlikuara duke u vendosur nëpër hapësirat e ndryshme me ngjyrë. Dritare të tilla, në banesat e shtr pasura, ndeshim thuajse në mbarë qytet Shkodër, Krujë, Tiranë, Berat, Gjirokastër, nga fillimi i shek. XIX, kryesisht në strukturat let druri, të cilat lejonin hapësira të mëdh resh, përhapen gjërësisht dritaret me rrësh cilat njiheshin edhe më parë. Kështu vendin këve prej druri filluan ta zënë tarabat me lëv tikale (fig. 2), dhe më rrallë me lëvizje hor Ky tip dritareje përhapet gjërësisht për t'u bë sundues gjatë shek. XIX, në mbarë tipologjin nesës qytetare shqiptare. Me zgjerimin e pë





Fig. 5

të xhamit, një telajo i dytë, me karkas druri dhe xhama, vendoset paralel me tarabat. Shpesh, veçanërisht në banesat e shtresave të pasura dritaret që shohim në rrugë, mbroheshin edhe me persiane.

Përfundimisht, brenda tipologjisë së banesës qytetare që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë në dritaret vërejmë një prirje të theksuar njësuese. Në këtë drejtim ndikim kanë pasur edhe mjeshtrat ndërtues. Ndryshimet në trajtim, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tipologjinë, por me variantet e ndryshme, pra shprehin diferencimin klasor të shoqërisë.

Oxhaku, i kuptuar në këtë rast, si bashkësia e vendit të zjarrit me tamburin tympritës, pra në dy prej përbërësve që marrin pjesë në formulimin e brendshëm të ambientit, është gjithashtu një element arkitektonik me rëndësi për t'u ndjekur në zhvillimin e tij. Në këtë element dallojmë dy lloje: oxhakë funksionalë dhe oxhakë dekorativë. Oxhakët funksionale i gjejmë në shtëpinë e zjarrit dhe në të gjithë ambientet e banimit. Oxhakët dekorativë i ndeshim vetëm në odat e miqve të shtresave të pasura. Oxhakët funksionale kanë variacione të ndryshme, të cilat lidhen kryesisht me trajtimin volumor të tamburit. Në shtëpinë e zjarrit oxhakët janë tepër të thjeshtë, dhe madje në disa raste edhe pa tambur. tij me mbulesën në trajtën e gjysëm shfaqje e rëndomtë në odat e ban nga tipi. Përkundrazi në oxhakët dek të miqve ndeshim në një larmi të dal ket formës së volumit të tamburit d trajtimit dekorativ të tyre. Karakteristi trajtimit të këtyre oxhakëve nuk lidl me tipologjinë, por me traditën lol drave të ndryshme. Kështu kemi c ndërmjet oxhakëve të odave të mic me çardak në Berat dhe Shkodër (e odave të miqve në banesën gjir gjithashtu paraqesin tipare të veçan mund të pohohet se në oxhakët fu e trajtimit në mbarë tipologjinë e b që lidhet me formacionin feudal, é qartë. Përkundrazi, trajtimi i oxhc paraqet variacione lokale, të cilat n drejtpërdrejt me tipologjinë.

Kompleksi musandër-trapazan, p stante në odën qytetare shqiptare q macionin feudal të shoqërisë. Ai ka caktuar qartë në kompozim. Ashtu s e tjerë, trajtimi i tij paraqet ndrysh shme përsa i përket ngarkesës deko hasuar ambientet e zakonshme me miqve. Përsa i përket kompozimit t të përbashkët, si ndarja në dy volur musandrën si dhe parahyrjet, përl ambientin ndërlidhës dhe atë san sipërmit si një hapësirë e vetme mbyllur, karakterizojnë këtë kompl këtyre kemi edhe dallime të cilat, d për ambientet e zakonshme dhe v odës së miqve. Në përgjithësi në o kompleks paraqitet mjaft i njësua edhe dallime, të cilat lidhen kryes e çdo qyteti. Ky njësim shpjegohet n ta në mënyrën e të jetuarit. Për t' se ky element nuk ndeshet në shtë banesës tiranase, si dhe të disa sh lluar të banesës me çardak. Në od mi i këtij kompleksi paraqet ndrysh dhen kryesisht me shkallën e përpu teve formues, mënyrën e mbylljes s zanit (fig. 6) si dhe në ndonjë ras kompozimit. Por edhe këtu karakteri

DO NOT COPY

DO NOT COPY







e gurit të brendshme apo të jashtme, para
njësi të theksuar. Kjo shprehet në përdorimi
të strukturave mbajtëse të rampave të shk
cilat ngrihen mbi qemer të shkallëzuar m
gjysëm dhe çerek rrethor. Krahasimi i kët
struksioneve në banesat e Shkodrës, Berati
dhe Gjirokastrës, është shumë tregues në k
tim. Shkallët e drurit gjithashtu paraqesin
dalluar me trajtimin e tyre të thjeshtë. Kj
shpjegohet kryesisht me faktorin e llojit të
ndërtimor.

Nga shqyrtimi i evolucionit dhe tipareve
elementeve të lartpërmendur, si dhe duke
parasysh elementet e tjerë, vërejmë se në
si këta paraqiten si faktorë të dalluar kon
duke mos qenë të lidhur me një tipologji
tuar, në kuadrin e shoqërisë feudale. Di
klasor dhe tradita lokale janë faktorët kry
përcaktojnë dallimet ndërmjet të njëjtëve
në banesa të ndryshme. Sa u parashtrua
me periudhën e feudalizmit të vonë. Është
res të ndjekim si qëndrojnë elementet arki
në proçesin e rëndësishëm të lindjes dhe
të marrëdhënieve kapitaliste, i cili pasqy

e banesës së re, ndryshimet në elementët arkitektonikë qenë tepër të rëndësishëm, dhe prekën mbarë repertorin e këtyre elementeve. Ky proçes përfshin krahas ritrajtimeve të reja të elementeve arkitekto-





nikë, edhe mënjanimin gradual der
disa elementeve. Prirja e përgjithshr
rritjes së vlerave estetike të elemen
së jashtme dhe thjeshtimi i përpuni
brendshëm, duke arritur një barastr
nimit të jashtëm me atë të brendshm
në krahasim me banesën tradiciona
trajtimit të brendësisë i kushtohej nj
më i madh. Fillimi i futjes së oren
ndikoi në përshpejtimin e proçesit të
pastaj të mos ndërtimit më të orendiv
bërëse e brendësive të banesave. K
ndjekim zhvillimin e katër elementev
edhe në këtë periudhë. Dritaret në
gjatë proçesit të rindërtimit në tipol
luajnë një rol të dorës së parë në
pamjeve të ndryshme dhe veçanërish
sore. Dritaret zmadhohen, duke parc
katërkëndëshe kënddrejta. Mbrojtja r
apo hekuri, fillon e humbet, ndërsa
rit ndërtohen rrallë. Persianet nuk
ndërsa grilat me hapje nga jashtë p
nga dielli i fortë, përhapen në mjaft
timi i jashtëm i dritareve bëhet më i
pari fashaturat prej druri dhe më pas
suva rrisin vlerat e dritares në koncep
së jashtme.

Kompleksi musandër-trapazan hu
tipologjinë e banesës së re. Së pari c
depozitë e thjeshtë në vendin tradici
shtë si një element më shumë dekorati
nal, për të mos u ndërtuar më, pasi
zëvëndësohet me mobiljet e kohës.

Oxhakët, gjithashtu pësojnë ndr
ndësi. Oxhakët dekorativë nuk ndë
kuadrin e thjeshtimit të përgjithshëm
të brendësisë. Oxhakët funksionalë
ndërtohen me forma mjaft të thjeshtë
risht në ambientin e shtëpisë së zja
shpeshtohen rastet e mosndërtimit
lidhen me futjen e sobave për ngroh
vetëm një kanal për tërheqjen e tymë

Shkallët e gurit nuk ndërtohen
mave tradicionale. Në përgjithësi venc
në shkallët e drurit, të punuara me
parmakë të formave të ndryshme, të

DO NOT COPY

riale të qëndrueshme, kryesisht me gurë, shpesh të daltuarë.

Përfundimisht vërehet se me lindjen e tipit të ri të banesës qytetare shqiptare dhe procesin e rindërtimeve të tipologjisë së vjetër, si pasqyrimi i kushteve të reja ekonomiko-shoqërore, elementet arkitektonikë pësojnë ndryshime të rëndësishme, ndërsa disa prej tyre si kompleksi musandër-trapazan, dollapët e murit, kamaret, sergjenet etj. largohen me shpejtësi nga repertori i mobilimit arkitektonik. Prirja njësuese në trajtimin e elementeve arkitektonik në këtë kontekst të ri shoqëror është më e theksuar në drejtimet kryesore se sa në tipologjinë e vjetër.

Një përbërës i rëndësishëm i veprës arkitektonike është edhe teknika e ndërtimit, e cila shpreh mënyrën e zgjidhjes së problemeve konstruktive nëpërmjet materialesh të ndryshëm ndërtimi. Teknika e ndërtimit në banesën qytetare shqiptare, ashtu si në çdo vepër ndërtimore, është e lidhur ngushtë me llojin e materialeve të ndërtimit të cilët paraqesin veti të ndryshme fiziko-mekanike. Lloji i materialit ka kushtëzuar shpesh edhe teknikën e ndërtimit. Kështu përdorimi i gurit ka mundësuar përdorimin e gjërë të strukturave të harkuara. Lënda e drurit me seksion krahasimisht të vogël, në Gjirokastër ka kushtëzuar skemat karakteristike të konstruksionit të çatisë, si dhe strehët me testekë.

Në të kaluarën për ndërtimin e banesave popullore qytetare janë përdorur gjërësisht materialet natyrore, kryesisht të pa përpunuara dhe më pak gjysëm, apo plotësisht të përpunuarë. Ndër këta vendin kryesor e zinte guri, argjila dhe druri. Guri shërbente dhe për prodhimin e gëlqeres. Ndërsa për mbulimin e çatisë përdoreshin tjegullat dhe rrallë rrasat e gurit. Përdorimi i tullës është një dukuri krahasimisht e re, që gjeti përhapje më tepër në Korçë, aty nga gjysma e dytë e shekullit të XIX.

Le të kalojmë tashti në marrëdhëniet ndërmjet tipologjisë dhe teknikës së ndërtimit, e cila siç vërejtëm është e lidhur ngushtë me llojin e materialit të ndërtimit. Shkalla relativisht e ulët e zhvillimit të forcave prodhuese i jepte parësi përdorimit të materialeve natyrorë, të ndodhur pranë vendit të ndërtimit, duke kushtëzuar kështu deri diku edhe teknikën e ndërtimit. Këto arësye bëjnë të kuptueshme përhapjen e teknikave të ndërtimit sipas zonash gjeografike. Kjo ndarje bën që në qendra të ndryshme të gjërë e të njëjtë në mbarë vendin. Për në zonat fushore mbizotëron ndërtimi i me qerpiç dhe më pakë me gurë lumi pa përjashtuar rastin e ndërtimit të pjesës me me gurë dhe të asaj të sipërmes, më tur nga agjentët atmosferikë, me qerpiç. Shkodër, Lezhë, Krujë, Berat e Gjirokastë met me gurë janë të vetmet. Në qytetet e së Mesme mbizotërojnë ndërtimet me qerpi jashtuar ato me gurë, apo me kombinimi

Kjo ndarje rajonale e materialeve dhe të ndërtimit të përdorura për ngritjen e qytetare, dhe mospërputhja e saj me tipo kësaj kategorie ndërtimore, shpreh qartaz sinë e tipologjisë nga teknika e ndërtimit. në këtë drejtim janë të shumtë. Kështu ba çardak e gjejmë të ndërtuar me gurë lumi dër, me gurë kave në Shkodër, Krujë, Elbas Korçë, etj, dhe me qerpiç në Elbasan, etj. A njëjtin tip banese e gjejmë të ndërtuar m të ndryshme, kuptohet se me të njëjtën tekn tohen tipe të ndryshme banese. Me teknikë lasht të qerpiçit gjejmë të ndërtuar banesë se, shumicën e banesave me hajat dhe t banesës korçare, të ndërtuar gjërësisht pas caktimit të kësaj qendre si kryeqytet i S

Pa cënuar vërtetësinë e përfundimeve përme, duhen mbajtur parasysh dy konsi mëposhtme. Teknika e ndërtimit edhe br qendre ka luhatje në përputhje me diferenc sor të shoqërisë, veçanërisht në qendrat hen dy të tilla. Konstatimi i dytë lidhet m pjen e gjërë të një teknike, e cila megjithë hur më parë, nuk ka qënë e zbatuar gjërës nika me skelet druri, mbushur me qerpiç, apo veshur me paretka, ka qenë e njohur sat e katër tipeve tradicionale, por me një tepër të kufizuar. Gjatë gjysmës së dytë të vërejmë një përhapje tepër të gjërë të kësa e cila lejonte hapjen e hapsirave të mëdh tareve daljet në formë erkeri dhe në përgjith pozime më dinamike. Me lindjen dhe zh marrëdhënieve kapitaliste, teknika e ndër son ndryshime më të pakta se ajo e komp ambienteve dhe elementeve arkitektonikë. theksuar janë fillimi dhe zgjerimi i përdorir llës, largimi më gradual nga suvatimi me ll

DOKTORATURA

Emin RIZA

LA TYPOLOGIE DE L'HABITATION URBAINE EN RELATION AVEC LA FORMULATION DES AMBIANCES, LES ELEMENTS ARCHITECTONIQUES ET I TECHNIQUE DE CONSTRUCTION

DO NOT COPY

La typologie de l'habitation en général et de celle urbaine en particulier en tant que représentante des caractéristiques principales de la composition de planimétrie et de volume, apparaît avec une nette évolution dans le temps. Cette évolution est le reflet des conditions économiques-sociales données, lesquelles directement ou indirectement influent sur l'habitation.

La diversité typologique de l'habitation à une période donnée, les différentes échelles des tendances convergentes ou divergentes, sa formulation architectonique et constructive, sont les principaux indics dans le passage du témoignage architectonique à la réalité historique sociale de cette période. Mais si nous nous arrêtions seulement à la composition, tout primaire qu'elle soit, nous aurions perdu d'autres facteurs importants pour suivre les traits et le caractère de l'habitation dans son évolution historique. La composition de l'habitation conceptée comme corrélation fonctionnelle des différentes ambiances dans le plan et dans le volume, présuppose la cristalisation de la formulation de ces ambiances, la connaissance d'un répertoire précis de différents éléments architectoniques ainsi que l'assimilaton à un niveau précis de la technique de construction. Pratiquement, ces trois éléments rendent possible la réalisation de l'oeuvre architectonique, donc de l'habitation aussi. A la différence de la composition, par leur nature la formulation des ambiances d'une habitation des éléments architectoniques ainsi que la technique de construction jouissent d'une indépendance relative envers la composition. Chacun de ces éléments constituants est différemment lié aux facteurs du domaine économique et social, du niveau des réalisations techniques de l'époque, des goûts esthétiques ainsi que de la nature des matériaux de construction. Cet article vise l'effort d'une analyse des corrélations entre la composition et les trois principaux éléments constituants déjà mentionnés, Ces rapports seront analysés essentiellement suivant la dynamique de l'évolution de ces trois éléments constituants, parallèlement à celle de la composition.

féodalisme récent (milieu du XVe sc. – milie qu'au début de l'apparition de l'influence ment des relations capitalistes dans l'habitatic début XXe sc.). On connait déjà les diffe dans la typologie des habitations de ces a dans cet examen on va traiter en particulie qui nous intéressent parce que les groupe représentent des différences de qualités.

Pratiquement la typologie de l'habitatior série de compositions d'un répertoire précis différentes formes de la composition, dans le principes compositionnels représentent de d du même type. Par conséquent, une compare férents types sera faite avec les variantes cor le niveau de leur évolution.

Tout d'abord nous allons voir les relati logie et la formulation des ambiances de l' le féodalisme récent. Ayant en vue les quat tation urbaine de cette époque, l'habitation porche, celle à «tchardak» et celle de Gj marquons qu'en général les ambiances simp d'une ressemblance dans leur formulation in type de l'habitation auquel elles appartienner ple les étables, les ambiances ouvertes de ressemblent. La maison du feu dans les var différents types apparaît par de nettes res que dans les variantes développées elle se

Comme on le sait déja, la chambre const cipales unités de l'habitation. Le nombre d la typologie de l'habitation urbaine albanais variantes. Concernant cette ambiance, à l'i type ainsi que entre les types différents, ressemblance quant à la composition de lc meubles, en tant que partie de l'architectu La composition de la chambre dans l'habita naise y compris la chambre des amis, rep

DO NOT COPY

la même position dans la composition de la chambre prouvent que la chambre est une unité remarquable dans l'habitation urbaine albanaise. Les différences quant aux éléments décoratifs à l'intérieur du même type, lesquelles s'approfondissent parallèlement à l'évolution des variantes différentes, expriment directement la différenciation de classe de la société urbaine alors qu'entre des types différents elles expriment les différents niveaux du développement économique et social des divers centres urbains.

Le comencement et l'élargissement des relations capitalistes dans notre pays qui se reflètent dans l'habitation vers le milieu du XIXe sc. avec l'apparition d'un nouveau type d'habitation, s'accompagnent de l'unification remarquable non seulement sur le plan typologique mais aussi sur celui de la composition et du façonnement de l'intérieur des ambiances de l'habitation. Les différences locales s'affaiblissent tandis que la différenciation de classe dans les ambiances de l'habitation se reflète essentiellement aux dimensions et aux matériaux de construction. L'ammeublement de l'intérieur, à la différence de la typologie traditionnelle où dans l'habitation étaient compris les meubles aussi en tant que partie organique laissait voir de grandes différences entre les classes et les différentes couches sociales.

Finalement, quant aux relations entre la composition et les unités constituantes de l'habitation on peut affirmer que la formulation de celles dernières représente en général une unité remarquable sur le plan compositionnel. Par conséquent il n'y a pas de corrélations étroites et directes entre elles.

Les éléments architectoniques qui ont évolué avec le temps réprésentent un important élément de l'habitation. Cette évolution se présente sous deux aspects. Le premier est lié à leur forme tandis que le deuxième au traitement décoratif. Comme dans la composition de l'habitation, dans celle de ses unités constituantes aussi, les réalisations avancées dans une phase du développement de la société urbaine ne se répandent pas simultanément dans toute la typologie de l'habitation. Il faut en chercher la cause dans la différenciation de classe laquelle oblige les couches pauvres de la population à conserver les anciens schémas compositionnels ainsi que les anciens éléments architectoniques parce qu'il est plus facile de les réaliser du point de vue économique.

Le renforcement de l'économie des villes ainsi que le renforcement de la différenciation de classe ont nettement influé à accélérer l'évolution des éléments architectoniques. Les recherches et les études actuelles nous permettent d'évidenter

Nous allons nous arrêter l'essence du problème p au rapport entre la typologie de l'habitation et les architectoniques en analysant quelques-uns des élé plus typiques pour obtenir les conclusions respective ment, nous allons traiter les fenêtres, le complexe «m trapazan», les cheminées et les escaliers. Ces éléments nels portent des décorations lesquelles apparaissent dans le complexe «musandër-trapazan et dans les des chambres des amis.

A l'intérieur de la typologie de l'habitation ur est liée à la formation féodale de la société on rem tendance accentuée d'unification à laquelle ont in les maîtres-constructeurs. Les changements dans le trai se rapportent pas directement à la typologie, mais férentes variantes, donc ils reflètent la différenciation de la société.

Dans les cheminées fonctionnelles l'unité de dans toute la typologie de l'habitation urbaine liée mation féodale, est un trait distinct, au contraire, le des cheminées décoratives représente des variations lc quelles ne semblent pas être liées directement à la

Le complexe «musandër-trapazan» est constant chambre urbaine albanaise qui est liée à la formatio de la société. Comme dans les autres éléments son représente d'importants changements quant à la déc l'on compare les ambiances ordinaires avec celle de mbre des amis. En ce qui concerne la composition, essentiels sont communs mais il y a aussi des différe quelles doivent être vues à part pour les ambiances et à part pour la chambre des amis.

En analysant l'évolution des fenêtres du compl sandër-trapazan» des cheminées et des escaliers, ainsi en vue les autres éléments, nous remarquons qu'en ils apparaissent comme de remarquables facteurs co n'étant pas liés à une typologie donnée dans le cac société féodale.

La différenciation de classe et la tradition lo les principaux facteurs qui déterminent les différences mêmes éléments dans de différentes habitations. Tou est exposé se raporte à la période du féodalisme r

Avec l'apparition du nouveau type de l'habitatio albanaise et le processus de la reconstruction de l typologie, en tant que reflet des nouvelles conditior miques-sociales, les éléments architectoniques subiss portants changements et quelques-uns tel le compl sandër-trapazan» les placards, etc., s'effacent rapide

l'habitation urbaine albanaise, comme dans chaque construction est étroitement liée au genre des matériaux de construction lesquels jouissent de différentes qualités physico-mécaniques.

L'état relativement peu évolué des forces productrices exigeait l'utilisation des matériaux naturels situés tout autours de l'endroit de la construction conditionnant ainsi dans une certaine mesure la technique de construction. C'est pour ces raisons que les techniques de construction diffèrent selon les zones géographiques. Cette répartition a fait que dans des centres différents l'on trouve les mêmes techniques d'une endurance comparablement longue.

Cette répartition régionale des matéri ques de construction utilisés à la construct urbaines, ainsi que sa discordance avec la catégorie de construction exprime clairement la typologie par la technique de constructio exemples sont nombreux.

Enfin, en comparaison avec les deux é déjà mentionnés la technique de constructi un facteur moins unificateur et en même mique lequel renferme de grandes possibilit réalisation d'une typologie variée.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Kristofor NASLAZI

DATIMI I DISA IKONAVE TË MANASTIRIT TË SHËN MËRISË TË POSTENANIT – LESKOVIK

Gjatë punës për studimin dhe sistemimin e fondeve të muzeut mundëm të veçojmë një pjesë të mirë ikonash, midis të cilave na tërhoqën vëmëndjen katër ikona të ardhura nga manastiri i Shën Mërisë të Postenanit që do të jenë edhe objekt i studimit tonë. Këto janë: ikona e Shën Mërisë (fig. 1), ikona e Krishtit Pantokrator (fig. 2), ikona e Johan Pagëzorit (fig. 3) dhe ikona e Shën e Premtes (fig. 4) me skena në miniaturë. Për ikonën e Johan Pagëzorit janë dhënë: mendime të ndryshme lidhur me datimin e saj. Kështu ajo njëherë është vlerësuar e shek. XVI-të[1] e njëherë tjetër e shek. të XVIII-të[2]. Ikona e Shën e Premtes me skena është vlerësuar si vepër e shek. XIV-të[3]. Kurse për dy ikonat e tjera nuk është dhënë asnjë mendim. Për vlerat artistike dhe datimin e tyre po japim konsideratat tona.



Ikonën e Shën Mërisë mundëm ta datojmë e pikërisht kjo do të na shërbejë si pikënisje për datimin e ikonave të tjera.

Shën Mëria është pikturuar në teknikën e temperës mbi grund gipsi, shtrirë mbi një panele dru arre. Ajo është paraqitur gati frontale deri në brez, me kokën e përkulur paksa nga fëmija që mban në prehër. Figura e saj kap gati 3/4 e sipërfaqes së ikonës ndërsa pjesën tjetër e zë sfondi i lyer me ar. Në dorën e majtë ajo mban Krishtin, ndërsa krahun e djathtë, gjysëm të përkulur me pëllëmbë të hapur e drejton nga ai. Shën Mëria është veshur me një mafor të kuq me nuanca kafe, i cili i mbulon kokën dhe pjesën e torsit me palëzime të dendura. Nën mafor dallohet paksa shamia e kokës në ngjyra qielli me nuanca okër dhe mëngoret e fustanit okër me viza të kuqe. Ndërsa Krishti foshnjë është vendosur për-

DO NOT COPY



Fig. 2. Krishti Pantokrator. Nr. inv. 4213 me përmasa 109 x 75 cm,



Fig. 3. Pagëzori. Nr. inv. 5096 me përm

formë bekimi. Ai është i veshur me himation me ngjyrë të kuqe angleze me nuanca portokalli, që mbulon gati gjithë trupin e tij, me palëzime të shumta. Ndërsa në himation dallohet hitoni me ngjyrë qielli dhe me zbukurime ari. Ngjyrat e karnacioneve në këtë ikonë kalojnë nga të ftohta në të ngrohta. Ato kanë ngjyrë bazë okrën në jeshil, që kalon në dritë me ashpërsime në nuancë rozë në të bardhë. Kjo ikonë është pikturuar me ngjyra

Dëmtimet e ngjyrave nuk na lejojnë të anët dekorative të tyre. Vizat e veshjeve janë të drejta, të thyera dh ara por mënyra e vendosjes së tyre që të ndihen volumet e brendësh të trupit. Vetë palat janë të sheshi janë shumë larg natyrshmërisë e li vizjeve të tyre.

Në sfondin e artë, mbi supin e dallohet një shkrim me gërma kap ngjyrë të kuqe (fig. 6) që shpreh një

DO NOT COPY

era me ar. Me kalimin e kohës ato janë rrafshuar disi, duke lënë të duken qartë motivet floreale të tyre. Sipër, mbi sfondin e artë, në të dy qoshet e tij janë pikturuar dy medalione të zbukuruar me ar, me inicialet e Shën Mërisë.

